



FLET PËR "EPOKËN E RE", ILIR IBRAHIMI FAQE 4-5

KOKËFORTËSIA ME SHBA-në SJELL PASOJA TË MËDHA DHE TË PARIPARUESHME



Analisti politik Ilir Ibrahim ka ftuar institucionet e Kosovës që të reflektojnë karshi kërkesave të ShBA-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se humbja e

besimit të ShBA-së do të sillte për Kosovën pasojë të mëdha dhe të pariparueshme. Sipas tij, sanksionimi më i madh do të ishte humbja e besimit të administratës amerikane për palën

e Kosovës. Ai ka vlerësuar se kjo do të çonte në një varg pasojash të cilat do ta vinin në pikëpyetje të qenit dhe funksionimin e Kosovës si shtet në familjen e shteteve të botës

OPINION

**AHTISARI PLUS,
KORRIGJIM I KUFIJVE,
VUÇIQI PLUS - PLUS, THAÇI
DHE KURTI MINUS, KURSE
GRENELLI TRUKUES!** F. 11

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE

**KDI-JA: KËRKOHEN VEPRIME
URGJENTE PËR TA PARANDALUAR
DEGRADIMIN E MJEDISIT NGA
INVESTIMET KAPITALE** F. 6

**KRYEZIU: QEVERIA KURTI
E SHEH BARAZINË GJINORE
SI PROCES ME RËNDËSI PËR
INTEGRIM NË BE** F. 7

EKONOMI



**OAK-u KËRKON NGA QEVERIA
NJË FOND PËR MBROJTJEN E
BIZNESEVE** F. 9

**POSTA E KOSOVËS LANSOI
PULLËN POSTARE 'FLORA'** F. 8

SPORT



**KOMITETI EKZEKUTIV I JEP
MBËSHETJE KRYETARIT ADEMI** F. 20

A po i rrezikon taksa marrëdhëniet Kosovë - ShBA?

Kosovës ditët e fundit i është shtuar presioni nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) për heqjen e taksës ndaj Serbisë dhe për rifillimin e dialogut. Të martën senatori amerikan David Perdue ka thënë se në rast se Kosova nuk e shfuqizon taksën ndaj Serbisë dhe nuk është e përkushtuar për paqen,

atëherë ShBA-ja duhet ta rishqyrtojë pranimin e saj në Kosovë. Këtë deklaratë e ka mbështetur djali i presidentit të ShBA-së, Donald Trump Junior. Edhe i dërguari i presidentit Trump për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, ambasadori Richard Grenell, e ka mbështetur deklaratën e senatorit

Perdue. Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi i ka kërkuar urgjentisht qeverisë që të mblidhet dhe të marrë vendime në përputhje me kërkesat zyrtare të ShBA-së. Ndaj këtyre zhvillimeve kanë reaguar edhe lideri i LDK-së, ai i PDK-së dhe Nismës, duke bërë thirrje për ruajtjen e partneritetit me ShBA-në FAQE 3

Qeveria miraton projektligjin për buxhetin e vitit 2020

FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Koronavirusi në Shqipëri, 10 persona të prekur



TIRANË, 10 MARS - Në Shqipëri ka shkuar në 10 numri i personave të prekur nga koronavirusi. Autoritetet e Shëndetësisë njoftuan të martën për zbulimin e 4 rasteve të reja. Nga të gjithë peronat e prekur, 3 janë që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, ndërsa shtatë të tjerët janë të afërm ose familjarë të rastit të parë të zbuluar, 28 vjeçit të kthyer nga Italia. Zëvendës ministrja e Shëndetësisë Mira Rakacolli, shpjegoi se deri më tani rezultojnë të shtruar në spital 4 persona, 3 në spitalin

Infektiv në Tiranë dhe një në Durrës. Të tjerët janë në vetë-izolim. Komiteti teknik, një strukturë e përbërë nga ekspertë u mblodh sërisht pas mesditës, për të diskutuar nëse do të duhet të merren masa të reja shitesë. Ndërkohë në shumë qytete të vendit ka nisur dezinfektimi i mjediseve publike. Ndërsa, të martën u vendos pezullimi i çdo lloj fluturimi apo lidhjeje detare me Italinë, pas vendimit të Qeverisë italiane për ta konsideruar të gjithë territorin e saj në një zonë të prekur.

Ministria e Shëndetësisë përsëriti thirrjen drejtuar qytetarëve që t'i ndjekin me kujdes rekomandimet zyrtare dhe të kujdesen posaçërisht për masat e higjienës personale. Për çdo rast të shfaqjes së shenjave të infeksionit respirator, si temperaturë, kollë, vështirësi në frymëmarrje, sidomos për personat që kanë histori udhëtimi me vendet e prekura apo kanë pasur kontakt me ta, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u lutet qytetarëve të lidhen me Urgjencën Kombëtare në nr. 127.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut presin dritë jeshile nga BE-ja

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Gent Cakaj tha se presim që shtetet anëtare të reflektojnë pozitivisht dhe të na japin dritë jeshile për fillim të negociatave dhe kjo është kruciale për t'i thelluar reformat në Shqipëri, për të forcuar kredibilitetin e BE-së në rajon dhe është investim i vlefshëm në interesin gjeostrategjik të vetë BE-së



SHKUP, 10 MARS - Vendimi që pritet të marrë Këshilli Evropian në mars për fillim të negociatave për anëtarësim me Shkupin e Tiranën do të ndikojë në gjithë rajonin. Këto janë konkluzionet e ministrave të jashtëm të rajonit gjatë takimit në Shkup në kuadër të Procesit të Berlinit. Ministri i Jashtëm i Malit të Zi, Sërhan Darmanoviq dhe zëvendësministri i Jashtëm i Bosnjë Hercegovinës, Josip Bërkiq thanë se do të ishte skajshmërisht demotivuese për shtetet e tyre nëse BE-ja nuk fillon negociatat me Maqedoninë e Veriut, e cila ndërroi emrin kushtetues dhe me Shqipërinë, e cila pastroi gjyqësorin. Ministrat e jashtëm të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, Nikolla Dimitrov dhe Gent Cakaj nuk shohin arsye për shtyrjen e mëtejshme të procesit, ka njoftuar Alsat. "Presim që shtetet anëtare të reflektojnë pozitivisht dhe të na

japin dritë jeshile për fillim të negociatave. Kjo është kruciale për t'i thelluar reformat në Shqipëri, për të forcuar kredibilitetin e BE-së në rajon dhe është investim i vlefshëm në interesin gjeostrategjik të vetë BE-së", tha Gent Cakaj, ministër i Jashtëm i Shqipërisë. Kurse ministri i Jashtëm i Maqedonisë Veriore, Nikolla Dimitrov tha se ka qenë optimist në qershor të vitit 2018 dhe në qershor e nëntor të vitit 2019. "Tani duhet të jemi të kujdesshëm dhe të presim, por mendoj se kemi rast jashtëzakonisht të fuqishëm dhe është shumë vështirë të thuhet "Jo". "Jo"-ja nënkupton zbehjen e ndikimit të BE-së në rajon", tha Dimitrov. Në këtë takim u theksua rëndësia e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore për integrim në BE. Ministri i Jashtëm i Kosovës,

Glauk Konjufca kërkoi ndihmë të koordinuar mes BE-së dhe SHBA-së për arritjen e marrëveshjes me Serbinë, ndërsa kryediplomatja bullgare, Ekaterina Zaharieva porositi shtetet e rajonit t'i zgjidhin problemet dypalëshe duke e vënë interesin e përgjithshëm mbi atë kombëtar. "Duhet të ruhet perspektiva evropiane e 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe të ruhet numri "6". E dimë se duhet të mësojmë nga rasti i Maqedonisë së Veriut, së cilës vetëm pasi nënshkroi marrëveshje me Greqinë iu tha se mund të vazhdojë përpara. Mesazhi është i qartë, duhet të

arrijmë marrëveshje me Serbinë në mënyrë që të ecim përpara", tha Glauk Konjufca, ministër i Jashtëm i Kosovës. "Një nga problemet e Ballkanit është fokusimi i tepërt në të kaluarën. Mos më keqkuptoni, nuk është keq të kujtoni historinë, por bazë për ndërtimin e së ardhmes së përbashkët është të diskutuarit pa emocione për të kaluarën. Liderët e 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor deklarojnë se anëtarësimi në BE është prioriteti i tyre kryesor, por e vërteta është se këto nuk duhet të mbeten vetëm fjalë. Të jesh pjesë e BE-së nënkupton të punosh për

interesin e përbashkët dhe jo vetëm atë kombëtar", tha Ekaterina Zaharieva, ministre e Jashtme e Bullgarisë. Procesi i Berlinit është nismë diplomatike e iniciuar në vitin 2014, që ta ndihmojë dhe jo zëvendësojë zgjerimin e BE-së me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Pos takimeve në Shkup, aktivitetet e sivjetshme të bashkorganizuara nga Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria do të përfundojnë me Samitin e vjeshtës në Sofje dhe shënon bashkëpunimin e parë të këtyre të njëjtë kandidat dhe një shteti anëtar.

BDI-ja sot konfirmon listat e deputetëve

SHKUP, 10 MARS - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) sot (e mërkurë) do të mbajë mbledhje të organeve të partisë në të cilën do të verifikohen emrat e kandidatëve për deputetë. Sipas deputetit Artan Grubi, 90% e kandidatëve në listë do të jenë figura të reja. Në pyetjen se pse në

mesin e bartësve të listave nuk ka figura të reja, Grubi tha se ata janë persona me përvojë në parti dhe disa prej tyre nuk kanë qenë kurrë deputetë. Në listë, sipas Grubit, pritet të ketë përfaqësim të grave prej mbi 40%. BDI-ja tashmë ka konfirmuar vetëm bartësit e listave. Në

njësia e gjashtë, Ali Ahmeti, njësia e pestë, Talat Xhaferi, njësia e tretë, Bekim Neziri, njësia e dytë, Arbër Ademi, kurse në njësinë e parë, Izet Mexhiti. Nga kjo parti thanë se në mbledhjen e kryesisë do të konfirmohet edhe lista për njësinë e katër zgjedhore.



A po i rrezikon taksa marrëdhëniet Kosovë - ShBA?

Kosovës ditët e fundit i është shtuar presioni nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) për heqjen e taksës ndaj Serbisë dhe për rifillimin e dialogut. Të martën senatori amerikan David Perdue ka thënë se në rast se Kosova nuk e shfuqizon taksën ndaj Serbisë dhe nuk është e përkushtuar për paqen, atëherë ShBA-ja duhet ta rishqyrtojë praninë e saj në Kosovë. Këtë deklaratë e ka mbështetur djali i presidentit të ShBA-së, Donald Trump Junior. Edhe i dërguari i presidentit Trump për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, ambasadori Richard Grenell, e ka mbështetur deklaratën e senatorit Perdue. Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi i ka kërkuar urgjentisht qeverisë që të mblidhet dhe të marrë vendime në përputhje me kërkesat zyrtare të ShBA-së. Ndaj këtyre zhvillimeve kanë reaguar edhe lideri i LDK-së, ai i PDK-së dhe Nismës, duke bërë thirrje për ruajtjen e partneritetit me ShBA-në



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 MARS - Duke komentuar zhvillimet politike në Kosovë dhe mungesën e një vendimi nga Qeveria e Kosovës për heqjen e taksës, senatori amerikan David Perdue, përmes një shkrimi në llogarinë e vet “Twitter”, ka shkruar se në rast se Kosova nuk e shfuqizon taksën ndaj Serbisë dhe nuk është e përkushtuar për paqen, atëherë ShBA-ja duhet ta rishqyrtojë praninë e vet në Kosovë. “Për më shumë se dy dekada forcat amerikane kanë ndihmuar ruajtjen e paqes mes Kosovës dhe Serbisë. Tani, me përparimin e bërë historik, Kosova duhet ta bëjë pjesën e vet dhe t’i shfuqizojë të gjitha tarifat e vendosura ndaj Serbisë. Nëse Kosova nuk është plotësisht e përkushtuar për paqe, atëherë ShBA-ja duhet ta rishqyrtojë praninë e vet atje”, ka shkruar senatori Perdue. Këto komente vijnë pasi Qeveria e Kosovës muajin e kaluar vendosi që nga data 15 mars ta heqë taksën ndaj lëndës së parë që importohet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Donald Trump Junior, djali i presidentit të ShBA-së, Donald Trump, ka mbështetur këtë deklaratë në “Twitter”, duke theksuar se “është koha që t’i kthejmë trupat në shtëpi”. Edhe i dërguari i presidentit Trump për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, ambasadori Richard Grenell, e ka mbështetur deklaratën e senatorit Perdue në “Twitter”. Grenell vazhdimisht ka kërkuar që qeveria Kurti t’i shfuqizojë në tërësi masat tarifore dhe ta mundësojë vazhdimin e dialogut me Serbinë. Po ashtu, deklarata e senatorit Perdue u mbështet edhe nga llogaria zyrtare në “Twitter” e Këshillit për Siguri Kombëtare në ShBA. I pyetur nga gazetarët lidhur me këtë deklaratë të senatorit Perdue, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një

konferencë për medie ka thënë se raporti i Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është special, i përjetshëm dhe duhet të kultivohet. “Unë mendoj dhe kam besim të plotë që relacioni me ShBA-në nuk do të mbetet pre e tekeve apo aspiratave të një politike të ngurtë dhe elektorale ditore, por do të kemi një fokus të vendimmarrjeve të shpejta, të qarta të kultivimit dhe forcimit të partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne, të gjithë liderët politikë të Kosovës, jemi të zëvendësueshëm. Partneriteti strategjik, i përjetshëm dhe i veçantë me ShBA-në, është i përjetshëm. Ai është vullneti i qytetarëve të Kosovës dhe ky vullnet duhet të zbatohet nga të gjithë liderët politikë të Kosovës dhe jo që raporti me ShBA-në të cenohet për shkak të një grushti të votave”, ka thënë Thaçi. Presidenti edhe përmes një deklarate në rrjetin social “Facebook” i ka kërkuar urgjentisht Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të mblidhet dhe të marrë vendime në përputhje me kërkesat zyrtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. “Mjaft e keni cenuar lidhjen tonë speciale me ShBA-në, pa të cilën nuk do ta kishim as lirinë, as shtetin dhe as të ardhmen. Me këtë qasje po vihet në pikëpyetje edhe vetë e ardhmja e shtetit tonë. Të gjithë ne, krerë institucionesh, liderë politikë apo qeveri, jemi të zëvendësueshëm. Por, jetike dhe të pazëvendësueshme për Republikën e Kosovës janë vetëm raportet me ShBA-në. Konfrontimi me ShBA-në është shumë i dëmshëm dhe një gabim i pafalshëm në historinë moderne të Kosovës”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në “Facebook”. Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara kanë hyrë në një fazë shumë delikate dhe kritike. Deklarata e tij bëhet pasi

senatori amerikan David Perdue, përmes një shkrimi në “Twitter”, ka shkruar se në rast se Kosova nuk e shfuqizon tarifen ndaj Serbisë dhe nuk është e përkushtuar për paqen, atëherë ShBA-ja duhet të rishqyrtojë praninë e vet në Kosovë. Në deklaratën e tij, Mustafa thotë se “si kryetar i LDK-së jam deklaruar qartë për heqjen e pakusht të tarifës, ndërkaq që reciprociteti të dakordohet me ShBA-në dhe BE-në, varësisht nga sjellja e Serbisë”. Anëtar i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), njëherësh sekretarit për Marrëdhënie Ndërkombëtare në këtë parti, Skënder Hyseni, është prituri në Shtëpinë e Bardhë nga i dërguari i posaçëm i presidentit Trump për dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori Richard Grenell. Hyseni përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se LDK-ja pajtohet dhe mbron qëndrimin që taksa të hiqet menjëherë dhe pa kushte, ashtu siç kërkohet nga presidenti Trump. Në një konferencë për media, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se kryeministri Albin Kurti është i paaftë dhe po rrezikon aleancën e Kosovës me ShBA-në. Ai ka theksuar se për ta

parandaluar një dëm të tillë, së bashku me deputetët e partive të tjera opozitare, kanë ftuar për sot (e mërkurë), në orën 15:00, një seancë të jashtëzakonshme. “Për të kërkuar llogari nga kjo qeveri e papërgjegjshme në raport me qasjen e saj ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, ka thënë Veseli. Lideri i opozitës ka ftuar qytetarët e Kosovës, mbi çdo dallim politik, ta ngrënë zërin kundërshtues para këtij rreziku, me pasoja të paparashikueshme. “Partia Demokratike e Kosovës i merr me shqetësim serioz paralajmërimet e fundit për Kosovën nga miku ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për tërheqjen e trupave ushtarake dhe suspendimin e programeve zhvillimore në vlerë prej qindra miliona dollarësh. Si asnjëherë më parë kjo aleancë e shenjtë mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës po vihet në rrezik nga një kryeministër i paaftë për të kuptuar e vepruar drejt, nga një kryeministër pa vizion e pa përgjegjësi. Për fat të keq, gjithnjë e më shumë po vërtetohet se kjo qeveri është rrezik për interesin e përgjithshëm nacional. Ky rrezik vjen nga kjo qeveri që ka mungesë të gatishmërisë për të

marrë përgjegjësi dhe vendime në interes të vendit dhe qytetarëve tanë”, ka thënë Veseli. Kurse lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se paralajmërimet për vendosjen e sanksioneve ndaj Kosovës nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe deklarata e senatorit Perdue për rishikimin e pranisë ushtarake amerikane në vendin tonë, vijnë si rezultat i papërgjegjësisë dhe joseriozitetit të kësaj mazhorance për të kuptuar që në çfarë situatë është vendi ynë. Ai ka thënë se serioziteti i koalicionit IV-LDK ka degraduar deri në tallje. “Ne, në vend se të shprehim mirënjohje për përfshirjen direkte të presidentit Trump dhe administratës amerikane në dialogun Kosovë - Serbi, në Prishtinë ende ka zëra hezitues. Iniciativave dhe këshillave për dialog që vijnë nga ShBA-ja, pa hezitim duhet t’u themi po. Dhe tani është momenti i fundit që të gjithë nga Prishtina të flasim me një zë. Po, ne pranojmë iniciativat dhe këshillat e juaja që mundësojnë arritjen e një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila do të rezultonte me njohje reciproke dhe anëtarësim në OKB”, ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Tema e dialogut me Serbinë i bënë bashkë Veselin, Haradinajn dhe Limajn

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka prituri të martën në takim kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli dhe atë të Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, me të cilët ka diskutuar për krijimin e unitetit të brendshëm politik për fazën finale të dialogut me Serbinë. Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se në ditët e ardhshme pret të takohet me liderët e partive e tjera

politike, duke bërë me dije se ftesë për takim i ka dërguar Albin Kurtit dhe Isa Mustafës. “Në kuadër të nismës për organizimin e Konferencës së Unitetit për Kosovën, sot kam zhvilluar një takim me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryetarin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Ishte vlerësim i përbashkët se Kosova, sot më shumë se kurrë, ka nevojë për unitet të

brendshëm politik në fazën e një epilogu të dialogut me Serbinë. Takimet konsultative me kryetarët e partive parlamentare do të vijojnë në ditët në vazhdim. Sot u kam dërguar nga një letër edhe kryetarit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, kryetarit të Listës Serbe, Goran Rakiq, si dhe përfaqësuesve të grupit parlamentar 6 plus”, ka shkruar Haradinaj.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, ILIR IBRAHIMI

KOKËFORTËSIA ME SHBA-në SJELL PASOJA TË MËDHA DHE TË PARIPARUESHME

Analisti politik Ilir Ibrahim ka ftuar institucionet e Kosovës që të reflektojnë karshi kërkesave të ShBA-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se humbja e besimit të ShBA-së do të sillte për Kosovën pasoja të mëdha dhe të pariparueshme. Sipas tij, sanksionimi më i madh do të ishte humbja e besimit të administratës amerikane për palën e Kosovës. Ai ka vlerësuar se kjo do të çonte në një varg pasojash të cilat do ta vinin në pikëpyetje të qenit dhe funksionimin e Kosovës si shtet në familjen e shteteve të botës

besimit të administratës amerikane për palën e Kosovës. “Kjo do të çonte në një varg pasojash të cilat mendoj se do ta vinin në pikëpyetje të qenit dhe funksionimin e Kosovës si shtet në familjen e shteteve të botës. Nëse Kosova për shkak të egove dhe inateve personale e humb partnerin më të rëndësishëm strategjik, atëherë një gjë e tillë nuk do të na falet”, ka thënë Ibrahim.

Më tej, ai ka ftuar spektrin politik vendor që të arrijë një konsensus. “Lidershipi kosovar sa më shpejt duhet të ndërtojë një konsensus dhe t’i ofrohet palës amerikane si partnere e besueshme. Kërkesat janë të qarta dhe ato duhet të plotësohen menjëherë. Duhet marrë vendime të guximshme dhe të pakalkuara. Duhet shkuar në dialog me një zë dhe me një qëndrim”, ka deklaruar Ibrahim, duke shtuar se vonesat në këtë drejtim do të sjellin pasoja. “Flitet se palët në dialog presin të ketë një kompromis prandaj, nëse

shkohet me një qëndrim të bashkuar, atëherë edhe përgjegjësia edhe kompromisi janë më të pranueshëm. Çdo vonesë, çdo kalkulim, çdo mbajtje inati apo egoje, do të sjellë pasoja e që kam frikë se nuk do të mund të sanohen për dekada të tëra”, është shprehur Ibrahim

“Epoka e re”: Z. Ibrahim, kryeministri Albin Kurti ka propozuar heqjen e pjesshme të taksës ndaj produkteve serbe. Si e keni parë këtë propozim të kryeministrit?

Ibrahim: Nëse shihet si hap i parë, ai do të dukej hap i mirë, por duhet analizuar edhe kontekstin e zhvillimeve të gjithëmbarshme globale dhe sidomos tani kur kemi një rol udhëheqës të ShBA-së në dialogun me Serbinë. Tanimë e kemi parë reagimin e administratës së ShBA-së e cila e ka quajtur këtë propozim si hap gjysmak i cili nuk është i mjaftueshëm. Nëse një hap i tillë do të ndërmerrej para një

viti, ndoshta do të ishte mirëpritur, por sot, kur kemi gjithë këtë angazhim në instancat më të larta të administratës amerikane për të arritur një marrëveshje Kosovë - Serbi, atëherë koha është për të vepruar dhe marrë vendime të guximshme, dhe jo gjysmë hapa të kalkulueshëm.

“Epoka e re”: ShBA-ja e ka kundërshtuar këtë veprim të qeverisë. A po rrezikohen raportet Kosovë - ShBA?

Ibrahim: ShBA-ja e ka bërë të qartë se kjo qasje kokëfortë e palës kosovare do të sjellë pasoja për vendin. Nëse lidershipi kosovar nuk arrin të ofrohet si një partner i besueshëm, atëherë si mund të presim nga superfuqia botërore të merret me ne. Mos të harrojmë se dy nga zyrtarët më të lartë në administratën amerikane, Këshilltari i Sigurisë Kombëtare, O’Brian dhe drejtori i Inteligjencës Kombëtare, Grenell, janë duke u marrë me Kosovën. Këta zyrtarë kanë qasje

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 MARS - Analisti politik Ilir Ibrahim ka bërë me dije se nëse Kosova nuk e dëgjon këshillën amerikane për ta hequr taksën ndaj Serbisë, pasojat do të jenë të mëdha për vendin. Ai ka deklaruar se kjo qasje kokëfortë e palës së Kosovës do të sjellë pasoja për vendin. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka

thënë nëse nuk plotësohen kërkesat e ShBA-së, këto pasoja do të jenë edhe të pariparueshme. “Ritheksoj edhe një herë, ShBA-ja është duke e kërkuar dhe pritur një partner të besueshëm te pala e Kosovës në këtë proces. Nëse pala e Kosovës nuk arrin ta ofrojë atë partner, pasojat do të jenë të mëdha. Dyshoj, edhe të pariparueshme”, ka thënë Ibrahim. Sipas tij, sanksionimi më i madh do të ishte humbja e



KËSHILLTARËT E MERKELIT DHE MACRONIT KONFIRMOJNË PËRKRAHJEN PËR PROCESET INTEGRUESE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Albin Kurti dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, kanë pritur në takime të ndara të martën një delegacion të Gjermanisë dhe të Francës, të udhëhequr nga këshilltari i kancelares Merkel, dr. Jan Hecker dhe këshilltari i presidentit Makron, Emmanuel Bonne.

Presidenti Thaçi në një deklaratë për media ka thënë se me këshilltarët e Merkelit dhe Macronit kanë biseduar për aktualitetin politik në vend dhe rajon. Thaçi ka thënë se në këtë takim ka kërkuar fillimisht të hiqen vizat, pastaj të mendohet për përfshirjen e Bashkimit Evropian (BE) në procesin e dialogut me Serbinë. Presidenti Thaçi ka thënë se nuk do të ulet në tavolinën e bisedimeve në Bruksel pa u hequr vizat nga Bashkimi Evropian. Pavarësisht kësaj, Thaçi ka thënë se nga këshilltarët e Merkelit dhe Macronit nuk ka dëgjuar asgjë të re sa i përket heqjes së vizave. Këtë delegacion e ka pritur në takim edhe kryeministri Albin Kurti. Sipas njoftimit të qeverisë, në këtë takim u fol për

perspektivat shoqërore dhe ekonomike, masat që ka marrë qeveria në lidhje me bashkëpunimin me Evropën, për linjat që duhet të nxiten për t'i shtyrë proceset e integritimit dhe lirinë e qarkullimit, me çështjet që duhet të adresohen në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi.

Edhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka pritur në takim delegacionin e Gjermanisë dhe të Francës. Në këtë takim, Osmani nënvizoi edhe një herë përkushtimin e Kosovës që të zhvillojë politika të fqinjësisë së mirë. Ajo ka theksuar se jetësimi i marrëveshjeve të nënshkruara si dhe përafrimi drejt marrëveshjes përfundimtare që rezulton me njohje reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, janë interes i qytetarëve të Kosovës.

Kryetarja Osmani ka potencuar se procesi i dialogut duhet të udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës ngaqë kështu e ka përcaktuar Kushtetuta e vendit dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese por, sipas saj, ky është edhe vullneti i qytetarëve të Kosovës, të cilët në zgjedhjet

e 6 tetorit e kanë përcaktuar qartë se kush duhet t'u prijë proceseve në vend. Për më tepër, ajo shtoi se edhe Serbia duhet të tregojë se është e interesuar për fqinjësi të mirë dhe normalizim të raporteve me Kosovën, duke ndërprerë kampanjën ilegale të çnjohjeve dhe duke larguar barrierat jotarifore që ka vendosur në raport me vendin tonë.

Kryetarja Osmani ka shprehur gatishmërinë që ta vazhdojnë bashkëpunimin me partnerët tanë ndërkombëtarë, por ka kërkuar edhe përkrahje në drejtim të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Sipas saj, Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për këtë proces, ndërsa Qeveria dhe institucionet e zgjedhura pas 6 tetorit po tregojnë përkushtim maksimal në luftën kundër korrupsionit.

Në anën tjetër, përfaqësuesit e Francës dhe të Gjermanisë, Bonne dhe Hecker, rikonfirmuan përkushtimin e vendeve të tyre për ta ndihmuar dhe mbështetur Kosovën në një proces të suksesshëm të dialogut dhe në procesin e integritimit në BE.

të drejtpërdrejtë dhe të përditshme te presidenti Trump. Nëse lidershipi i Kosovës me papjekurinë e vet tregon se nuk është i denjë për një partneritet të tillë, atëherë si mund të presim që këta zyrtarë të na marrin seriozisht.

“Epoka e re”: Cilat mund të jenë pasojat për Kosovën nëse nuk e dëgjon këshillën e ShBA-së?

Ibrahimi: Shpesh dëgjojmë zëra se pse po i bëhet gjithë ky presion Kosovës dhe jo Serbisë. Mos të harrojmë se deri vonë, madje edhe sot në qarqe të caktuara, ShBA-ja në Serbi shihet si një vend armik. Ishte ky vend i cili në krye të NATO-s e bombardoi Serbinë për 78 ditë. Ishte sërish ky vend që orkestroi shpalljen dhe njohjen e pavarësisë së Kosovës. Mos të harrojmë që në atë kohë ishte sulmuar Ambasada e ShBA-së në Beograd. Prandaj analiza duhet të bëhet në këtë kontekst. ShBA-ja e bën gjithë presionin mbi Kosovën që ta ketë 100 përqind në krah, për të arritur një marrëveshje me Serbinë. Si do t'i mund t'i bëhet presion Serbisë, kur Kosova, si projekt i ShBA-së, po bëhet pengesë e procesit? E ritheksoj edhe një herë, ShBA-ja është duke e kërkuar dhe pritur një partner të besueshëm te pala e Kosovës në këtë proces. Nëse pala e Kosovës nuk arrin ta ofrojë atë partner, pasojat do të jenë të mëdha. Dyshoj, edhe të pariparueshme.

“Epoka e re”: Është përmendur edhe mundësia e sanksioneve. Çfarë do të thotë për Kosovën në qoftë se ShBA-ja vendos ndonjë sanksion ndaj saj?

Ibrahimi: Dënimi apo sanksioni

më i madh do të ishte humbja e besimit të administratës amerikane për palën e Kosovës. Kjo do të çonte në një varg pasojash të cilat mendoj se do ta vinin në pikëpyetje të qenit dhe funksionimin e Kosovës si shtet në familjen e shteteve të botës. Nëse Kosova për shkak të egove dhe inateve personale e humbet partnerin më të rëndësishëm strategjik, atëherë një gjë e tillë nuk do të na falet. Historia e shqiptarëve, fatkeqësisht, është e dominuar nga përçarja dhe lufta individuale ndërmjet fraksioneve të ndryshme. Nëse një gjë e tillë na përsëritet edhe në shekullin 21, atëherë nuk duhet ta fajësojmë askënd pse jemi ku jemi.

“Epoka e re”: Çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës dhe partitë politike në mënyrë që Kosova të mos i rrezikojë raportet me partneren strategjike, ShBA-në?

Ibrahimi: Lidershipi kosovar sa më shpejt duhet të ndërtojë një konsensus dhe t'i ofrohet palës amerikane si partnere e besueshme. Kërkesat janë të qarta dhe ato duhet të plotësohen menjëherë. Duhet marrë vendime të guximshme dhe të pakalkuara. Duhet shkuar në dialog me një zë dhe me një qëndrim. Flitet se palët në dialog presin të ketë një kompromis, prandaj nëse shkohet me një qëndrim të bashkuar, atëherë edhe përgjegjësia, edhe kompromisi janë më të pranueshëm. Çdo vonesë, çdo kalkulim, çdo mbajtje inati apo egoje, do të sjellë pasojë e që kam frikë nuk do të mund të sanohen për dekada të tëra.



KDI-ja: Kërkohen veprime urgjente për ta parandaluar degradimin e mjedisit nga investimet kapitale

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Kontratat publike për investimet kapitale me interes publik si ato për ndërtimin e rrugëve, rrjeteve të kanalizimeve dhe hidrocentraleve shpesh po bëhen burimi kryesor i degradimit të ambientit: lumenjve, tokës dhe pyjeve.

Sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (Kadastrës të ndotësve të ujërave të zeza), 72 për qind e ndotjes së lumenjve vjen nga rrjetet e kanalizimeve, ndërsa sipas raporteve të Bankës Botërore, në Kosovë rreth 760 persona përballen me vdekje të parakohshme çdo vit nga ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit dhe mjedisit.

Për ta ngritur vëmendjen e publikut për dëmet dhe efektin negativ të këtyre projekteve në mjedis e sidomos për të kërkuar veprim të menjëhershëm institucional, të martën KDI-ja ka publikuar tri raporte hulumtuese që shpërfaqin degradimin e

ambientit nga investimet kapitale në Kosovë e që janë me interes publik. Këto studime në veçanti trajtojnë tri tema të rëndësishme si ajo e ndërtimit të hidrocentralit në Biti të Poshtme, ndotjen e lumenjve nga derdhja e ujërave të zeza dhe dëmtimin e pyjeve nga gurthyesit.

Gjatë elaborimit të gjetjeve kryesore, Diana Metushi Krasniqi nga KDI-ja ka theksuar se degradimi i mjedisit përmes këtyre projekteve po shkakton probleme në mirëqenien, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve të Kosovës. Sipas KDI-së, këto po ndodhin si rezultat i mungesës së udhëzuesve administrative që plotësojnë kërkesat ligjore, kolizionit ndërmjet strategjive shtetërore dhe mungesës së llogaridhënies. “Vetëm gjatë tri vjetëve të fundit institucionet publike kishin dhënë kontrata në vlerë mbi 1 miliard euro për ndërtim të rrugëve dhe rrjeteve të kanalizimit, me masa minimale të mbrojtjes së mjedisit. Ajo tutje shtoi se “për të tejkaluar këtë



situatë është tejet e rëndësishme që të ndërtohet bashkëpunimi i mirëfilltë ndërmjet dikastereve qeveritare, të përditësohen ligjet dhe strategjitë nacionale dhe të rritet niveli i llogaridhënies publike”, ka thënë ajo.

Avni Zogiani, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit, ka potencuar problemet e bashkëpunimit edhe ndërmjet vetë departamenteve brenda

ministrisë, ndërsa ka përmendur që qeveria e re është e përkushtuar që ta harmonizojë legjislacionin dhe ta promovojë ekspertizën e mirëfilltë në mbrojtje të mjedisit. Në ndërkohë, Fatmir Gërguri, kryeinspektor në Komisionin e Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, ka ngritur shqetësime lidhur me aktivitetet ilegale të gurthyesve dhe dënimet

e vogla përkundër raportimeve të këtij institucioni.

Ai theksoi problemin e mosangazhimit të autoriteteve kontraktuese për t'i luftuar këto aktivitete sidomos në kontratat publike. Pasojat e mihjeve ilegale, përveç që po dëmtojnë në inkasimin e taksave, ato po rezultojnë në cilësi të dobët të punëve, pasi që rrugët e ndërtuara po prishen menjëherë.

Lumezi kërkon angazhim më të madh nga kryeprokurorët e prokurorive



PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka mbajtur kolegjiun e radhës me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive themelore në vend, kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale si dhe me kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit. Gjatë këtij takimi kryeprokurori Lumezi ka kërkuar angazhim më të madh dhe rol më aktiv nga kryeprokurorët në mbikëqyrjen e punës në prokuroritë të cilat ata i drejtojnë. Në këtë kontekst, është kërkuar që të ketë raportim javor për punët, të arriturat dhe sfidat në menaxhimin e

prokurorive përkatëse, duke avancuar kështu komunikimin dhe informimin e brendshëm ndërmjet kryeprokurorëve me kryeprokurorin e Shtetit. Gjithashtu, në këtë takim është kërkuar që të zbatohet në përpikëri edhe Rregullorja për Shërbimin e Komunikimit Publik të Sistemit Prokurorial nga ana e prokurorëve dhe kryeprokurorëve ashtu siç është e caktuar edhe me nenet përkatëse të kësaj rregulloreje. Ky takim ishte në vazhden e kolegjiuneve të rregullta të cilat i mban Kryeprokurori i Shtetit me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive në nivel vendi.

Ministrja Bajrami vizitoi AShAK-un

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Hykmete Bajrami, ka vizituar të martën Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (AShAK), ku është pritur nga kryetari i Akademisë, Mehmet Kraja dhe kryesia. Gjatë këtij takimi kryetari Kraja e informoi ministren Bajrami për punën dhe për aktivitetet e AShAK-ut, me fokus të veçantë rreth një dokumenti/platforme që po e përgatit Akademia në bashkëpunim me ekspertët e fushës edhe jashtë Akademisë. Ky

dokument ka të bëjë me çështjen e sistemit të arsimit në Kosovë, ku do të identifikohen të metat dhe vështirësitë me të cilat po përballen sistemi, si dhe do të jepen rekomandime se si të përmirësohet ai.

Ministrja Bajrami e mirëpriti kontributin e AShAK-ut dhe theksoi se përfundimet që do të dalin nga dokumenti i Akademisë do të shërbejnë si udhërrëfyes dhe do të trajtohen me kujdes nga Ministria, në mënyrë që MASHTI në bashkëpunim me AShAK-un dhe gjithë komunitetin e ekspertëve të arsimit të punojnë



së bashku për përmirësimin e sistemit të arsimit. Në këtë takim,

ministrja Bajrami dhe kryetari Kraja u pajtuan që ta shtojnë

bashkëpunimin mes dy institucioneve.

Ndahen 10 milionë euro për t'u mbrojtur nga koronavirusi

Qeveria e Kosovës ka miratuar planin për gatishmëri dhe reagim kundër koronavirusit. Kostoja e këtij plani kap shifrën mbi 10 milionë euro. Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka bërë me dije se kanë formuar një komitet multidisciplinar. “Kemi bërë përgatitje që disa klinika, që janë porta hyrëse, si Emergjenca, Infektivja, Pediatria, të jenë në gatishmëri të plotë në rast nevojë”, ka thënë Sejdiu. Ndërkaq Ministria e Arsimit ka ftuar të martën në takim drejtorët e drejtorive komunale të arsimit, me të cilët ka bashkërenduar veprimet parandaluese rreth situatës epidemiologjike të koronavirusit



të plotë në rast nevojë”, ka thënë Sejdiu. Ai ka theksuar se këto klinika dhe të tjerat janë

furnizuar mjaftueshëm me barna, material shpenzues dhe masa të tjera mbrojtëse që

kërkohen në të tilla raste. Drejtori Sejdiu, ndër të tjera, ka cekur edhe ngritjen e gatishmërisë për higjienë më të mirë në klinika e, po ashtu, masa për sigurim fizik.

Ndërsa Lindita Ajazaj-Berisha, drejtoreshë në Klinikën Infektive, ka thënë se në Klinikën Infektive kanë hospitalizuar gjashtë pacientë dhe dy të tjerë janë ende duke u kontrolluar. Ajo ka folur edhe për gjendjen e pacientëve të hospitalizuar, duke thënë se gjendja e përgjithshme e pacientëve është e mirë. Më tej, ajo ka theksuar se në klinikë çdo ditë ka raste të dyshuara dhe është normale që do të vijnë pacientë me simptoma të lehta për të kërkuar ndihmë. Në fund, ajo bëri me dije se për momentin nuk ka pacientë që kanë simptoma më të theksuara, kurse rastet vijnë nga Maqedonia, Anglia dhe vende të tjera që janë të prekur nga koronavirusi.

Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, ka thënë se kanë formuar një komitet multidisciplinar. “Kemi bërë përgatitje që disa klinika, që janë porta hyrëse, si Emergjenca, Infektivja, Pediatria, të jenë në gatishmëri

MAShTI dhe DKA-të bashkërendojnë veprimet parandaluese rreth situatës epidemiologjike të koronavirusit

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) ka ftuar të martën në takim drejtorët e drejtorive komunale të arsimit, ku është diskutuar rreth situatës epidemiologjike të koronavirusit COVID-19 dhe masave parandaluese që duhet të ndërmerren në shkolla. Me këtë rast, drejtorët e DKA-ve janë informuar nga ministria Hykmete Bajrami, se në bazë të Planit të Veprimit të miratuar nga Qeveria e Kosovës, MAShTI ka hartuar një plan veprimi në sektorin e arsimit, i cili parasheh

udhëzimet për marrjen e masave parandaluese në shkolla, bashkërendimin e veprimeve dhe komunikimin shkollë-DKA-MAShTI. Ministria Bajrami ka kërkuar nga DKA-të që t'i furnizojnë me material higjienik shkollat dhe të bëhet dezinfektimi i hapësirave shkollore. Megjithatë, ministria Bajrami ka theksuar se nuk ka hapësirë për panik, por ka thënë se ne duhet t'i marrim të gjitha masat parandaluese. Përdërisa nuk ka asnjë rast të koronavirusit në Kosovë, pra as rekomandim për

ndërprerje të mësimin nga ana e IKShP dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ministria Bajrami u bëri thirrje nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve që mësimi të zhvillohet normalisht, duke theksuar gjithmonë nevojën e higjienës së shtuar. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe drejtori i IKShP-së, Naser Ramadani, i cili i ka informuar drejtorët rreth situatës epidemiologjike me koronavirus në botë dhe në Kosovë dhe ka theksuar se, fatmirësisht, Kosova nuk ka asnjë rast të konfirmuar.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 MARS - Në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë së Kosovës është rekomanduar për qeverinë që të ngritët niveli i gatishmërisë dhe ka aprovuar planin për gatishmëri dhe reagim kundër koronavirusit së bashku me planin e veprimit. Vendimi obligon Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Financave dhe Transfereve dhe institucionet e tjera relevante, t'i kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij plani. Kostoja e këtij plani kap shifrën mbi 10 milionë euro.

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka konstatuar se kërcënimet nga shtrirja e këtij virusi në vendin tonë janë rritur për shkak të shtrirjes së tij në vendet fqinje, por që në situatën tonë aktuale nuk ka vend për kurrfarë paniku, se të gjitha rastet e testuara deri tani te ne kanë rezultuar negative.

Në një prononcim për media, lidhur me shqetësimet që janë ngritur për koronavirusin, drejtori i përgjithshëm i

Kryeziu: Qeveria Kurti e sheh barazinë gjinore si proces me rëndësi për integrim në BE

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Zëvendësministri i Integritimit Evropian, Taulant Kryeziu, ishte pjesë e panelit për të diskutuar për zbatimin e MSA-së dhe aspektin e barazisë gjinore në këtë proces. Ky aktivitetet është organizuar nga Instituti KIPRED në kuadër të projektit “Ngritja e llogaridhënies dhe kapaciteteve të institucioneve të Kosovës lidhur me zbatimin e aspektit gjinor të MSA-së”, me ç'rast është prezantuar raporti i titulluar “Mësimet e fituara dhe planifikimi për të ardhmen: Analiza gjinore e Programit



Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2019-2023”.

Me këtë rast zëvendësministri Kryeziu bëri një përmbljedhje të nivelit të zbatimit të MSA-së

gjatë këtyre katër viteve, që nga hyrja në fuqi e saj, po ashtu agjendës evropiane të reformave. Ai, gjithashtu, theksoi rëndësinë që ka aspekti gjinor në këtë proces dhe disa nga çështjet që duhen trajtuar me prioritet gjatë këtij viti. Ai nënvizoi se për Qeverinë Kurti aspekti gjinor në përgjithësi është prioritet që është reflektuar si në Programin e Qeverisë, të miratuar javën e kaluar, ashtu edhe në fushat prioritare të MSA-së si marrëveshje e detyrueshme për integrim në BE.

Zëvendësministri Kryeziu gjithashtu theksoi se Ministria e Integritimit Evropian dhe qeveria në tërësi janë të gatshëm për ta përmirësuar integrimin gjinor në tërë kornizën e politikave për integrim evropian, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile. Përveç zëvendësministrit Kryeziu, në panel mori pjesë edhe Reyes Charle-Cuellar, këshilltare gjinore në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Taulant Hoxha, drejtor ekzekutiv i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Bislimi dhe përfaqësuesit e Bankës Botërore diskutuan për sistemin social në Kosovë



Prishtinë, 10 mars (ER) - Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka pritur të martën në takim një delegacion të Bankës Botërore, i kryesuar nga ekonomistja e

lartë e Bankës Botërore, Stefanie Brodmann, me të cilën ka diskutuar për bashkëpunimin ndërinstitucional, veçanërisht në fushën e reformës së

sistemit social në Kosovë. “Me këtë rast u diskutua edhe për prioritetet e Qeverisë Kurti në lidhje me përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale, përfshirë përmirësimin e

rezultateve të punësimit si dhe për mundësitë e bashkëpunimit me Bankën Botërore në këto fusha. Në këtë takim u diskutua edhe për nevojën e identifikimit të

përfituesve të sistemit social si dhe programeve të tjera për mbrojtje sociale dhe shëndetësore”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Suspendohet nga puna inspektori tatimor

Prishtinë, 10 mars (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se, bazuar në informatat e pranuar nga organet kompetente dhe duke u mbështetur në nenin 69 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ka marrë vendim mbi pezullimin parandalues nga marrëdhënia e punës në ATK, për inspektorin tatimor S. S. i cili është arrestuar nën dyshimet se ka keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar si dhe ka marrë rryshfet. Rasti në fjalë nga Divizioni i Standardeve Profesionale i ATK-së

është dërguar në Drejtorinë për Krime Ekonomike dhe Korrupsion në Policinë e Kosovës më 11. 12. 2019. Menaxhmenti i ATK-së ka siguruar opinionin se çdo informatë e dëshmuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe rasteve korruptive do të dërgohet në organet kompetente për trajtim dhe ndaj të gjithëve që shpallen fajtorë për vepra penale do të ndërmerren masat e largimit nga marrëdhënia e punës. ATK falënderon mediat, Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për mbështetjen në luftimin e dukurive negative.



Posta e Kosovës lansoi pullën postare 'Flora'

Prishtinë, 10 mars (ER) - Posta e Kosovës nga dita e martë ka lëshuar në qarkullim emisionin e pullave postare të titulluar “Flora”. Sipas një njoftimi të Postës së Kosovës, pamjet e mrekullueshme të pesë pullave postare shfaqin pesë llojet e florës së begatshme, bimët: Burgull i Koshaninit, Halaqi i endtnerit, Tisi, Sanguisorba albanica, Primula Halleri të cilat janë të përhapura në Republikën e

Kosovës. “Bukuria e këtyre bimëve, e dizajnuar për pulla postare nga autorët D. Luta dhe L. Ademi, është e përmblodhur në një tabak të kombinuar me vinjetë si produkt final filatelik. Filatelia e Postës së Kosovës me përkushtim të lartë, si çdoherë, prezanton shtetin me florën mahnitëse që rritet në vendin tonë”, është bërë me dije në njoftimin e Postës së Kosovës.



Ministrja Hajdari: Turqia, një nga investitorët kryesorë në Kosovë

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS), Rozeta Hajdari, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, me të cilin kanë diskutuar për bashkëpunimin ekonomik në

mes të dy vendeve. Ministrja Hajdari ka shprehur mirënjohje për Turqinë, që është një nga investitorët më të mëdha në Kosovë, duke shprehur vullnetin për ta thelluar bashkëpunimin. “Turqia është një nga investitorët kryesorë në Kosovë dhe ne dëshirojmë ta thellojmë bashkëpunimin ekonomik, veçanërisht në

fushën e investimeve të huaja”, u shpreh Hajdari. Ndërsa ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, ka uruar ministrin për postin, duke thënë se Kosova është vend i veçantë për Turqinë. Ambasadori turk u shpreh i gatshëm për ta mbështetur ministrin Hajdari në projektet e ardhshme.



Qeveria miraton projektligjin për buxhetin e vitit 2020

Qeveria e Kosovës ka miratuar të martën projektligjin për buxhetin e vitit 2020, i cili do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës për miratim. Projektbuxheti parasheh të hyra të përgjithshme në vlerë prej 2.3 miliardë eurosh. Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka vlerësuar se ky buxhet do të sigurojë qëndrueshmëri të rritjes ekonomike të vendit

bruto produktit nacional. Ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka vlerësuar se ky buxhet do të sigurojë qëndrueshmëri të rritjes ekonomike të vendit. Dy vendime të miratuara nga kabineti qeveritar në këtë mbledhje adresojnë dinamizmin e realizimit të projektit të ndërtimit të rrugës nacionale Prishtinë - Mitrovicë. Vendimi i parë ka anuluar dhe plotësuar vendimin e qeverisë të datës 11 dhjetor të viti 2013, ndërsa vendimi tjetër ka miratuar shqyrtimin e mëtejshëm të shpronësimeve të pronave publike nga ndërtimi i kësaj rruge në segmentin Gojbulë - Smrekovicë. Qeveria e Kosovës ka rithemeluar Komitetin Drejtues të Projektit të Asistencës Teknike “Energjia nga

linjiti”. Anëtarë të këtij komiteti me të drejtë vote janë emëruar: Rozeta Hajdari, ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, kryesuese; Besnik Bislimi, ministër i Financave dhe Transfereve, anëtar; Lumir Abdixhiku, ministër i Infrastrukturës dhe Ambientit, anëtar; Emilija Rexhepi, ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar, dhe Ivan Milojeviq, ministër i Zhvillimit Rajonal, anëtar. Me vendimin e miratuar në mbledhjen e kabinetit qeveritar janë emëruar edhe anëtarët vëzhgues të Komitetit Drejtues nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Korporatës Energetike të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe

Minerale. Komiteti Drejtues do të marrë vendime në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me projektin e termocentralit “Kosova e Re”. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe vendimin me të cilin i kërkohet Agjencisë Kosovare të Privatizimit që t'i pezullojë për afat të pacaktuar të gjitha veprimet në lidhje me pronat e paluajtshme nga “Lista e aseteve për qiradhënie me karakter specifik e të azhurnuar”, e shpallur më 5 mars 2020. Vendimi është marrë në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe duke marrë parasysh Programin e Qeverisë 2020-2023, që parasheh politika për administrimin afatgjatë të pronës publike dhe shoqërore.

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 MARS - Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e zhvilluar të martën ka miratuar Projektligjin për Buxhetin e vitit 2020. Projektligji parasheh një total të të hyrave në shumën prej 2 miliardë e 20

milionësh, që shënon një rritje prej 7 përqindësh në krahasim me vitin e kaluar dhe një total të shpenzimeve prej 2 miliardë e 357 milionë eurove. Parashikimet për rritjen ekonomike janë në 4.2 për qind, ndërsa inflacioni prej 1.3 përqindësh, kurse deficitin buxhetor paraqet 2 për qind të



OAK-u kërkon nga qeveria një fond për mbrojtjen e bizneseve

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që t'i ndërmarrë masat e nevojshme duke siguruar një fond të veçantë për mbrojtjen e bizneseve në rast se koronavirusi do të krijojë një gjendje paniku siç është duke ndodhur në shumë vende të botës. Sipas OAK-ut, ky fond do

të duhej për mbrojtjen e bizneseve në rast të vështirësive të paparashikuara që mund t'i kenë për pagesat e pagave për punëtorët, tatimeve dhe kredive. “Depërtimi me shpejtësi të madhe i këtij virusi ka shkaktuar shumë panik dhe ka bërë që shumë shtete t'i mbyllin kufijtë dhe të shkaktohen miliona humbje të

bizneseve që operojnë. Një gjë e tillë në vendin tonë do të ishte edhe më e dukshme bazuar në faktin se varemë 90 për qind nga produktet e importit”, thuhet në komunikatën e OAK-ut. Krahas masave të menjëhershme në aspektin shëndetësor, OAK-u ka bërë thirrje që të merret parasysh edhe faktori ekonomik.





Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

AHTISARI PLUS, KORRIGJIM I KUFIJVE, VUÇIQI PLUS - PLUS, THAÇI DHE KURTI MINUS, KURSE GRENELLI TRUKUES!

Kush fiton dhe kush nuk fiton: Kosova po i nënshtrohet një presioni për një taksë sikur që qendra e Walt Street-it të ishte në Prishtinë dhe jo në New York. Për një taksë që shtetet normale e vendosin kur të duan, sa të duan dhe si të duan, Kosova po i nënshtrohet një terrorizimi që do të ishte i paimagjinueshëm edhe për Kinën si fuqi e dytë ekonomike botërore, në kohën kur një numër i madh i qytetarëve të vendit janë në asistencë sociale. Është e vërtetë se taksa është vendosur si digë politike ndaj veprimeve të shfrenuara të Serbisë e që nuk pengojnë as nga shtetet e BE-së e as nga amerikanët e Trampit dhe të Grenellit, por se kishte edhe efekt anësor ekonomik duke e lënë arkën e Vuçiqit pa, së paku, 500 milionë euro në vit. Në këtë mënyrë, bërlloku prodhues i Serbisë e që nuk i pranonte asnjë shtet në botë, gjente vend në Kosovë falë disa biznesmenëve kosovarë, sekserë të Serbisë që e ngritën kapitalin pikërisht me ndihmën e Serbisë. Ishte dhe është një situatë jonormale; paramendojeni që izraelitët të

blinin gjëra ushqimore dhe mallra të tjera nga gjermanët, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore?! Është fakt i ditur se pas formimit të Izraelit në vitin 1948, duke okupuar toka palestineze dhe arabe, izraelitët demonstuan një nacional - patriotizëm ekonomik duke mos blerë fare mallra palestineze ndonëse ishin pesfish më lirë se ato izraelite. Kështu duhet të veprojnë edhe qytetarët e Kosovës duke mos e blerë edhe asnjë prodhim të vetëm që vjen nga Serbia. Mirëpo, është shumë e vërtetë se edhe pleqnarët ndajnë, kryesisht padrejtësi, për faktin se në të shumtën e rasteve drejtësia është për të fortët dhe presioni për të lëshuar rrugë bie mbi ta, të dobët dhe të pa krahë. Në fillim të viteve '90, një delegacion nga Kosova (Baca Adem Demaçi, Ibrahim Rugova dhe Veton Surroi) u takua në Beograd me sekretarin e shtetit, z. Bejker, i cili ia bëri të qartë se ShBA-ja përkrah integritetin territorial të Jugosllavisë dhe se shqiptarët e Kosovës mund ta kërkojnë realizimin e të drejtave

vetëm në kuadër të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë. Askush nuk reagoi për këtë dhe pasojat erdhën më vonë. Paraprakisht Serbia ia kishte hequr autonominë Kosovës, nën presion dhe me dhunë dhe askush nuk reagoi. U larguan nga puna thuaja të gjithë të punësuarit shqiptarë, përjashtuar një numër që vazhdoi të punojë e që punon edhe sot në vende të mirëpaguara në institucionet e Kosovës, u mbyllën të gjitha institucionet arsimore, shëndetësore dhe biznesore dhe nuk pati reagime. Vriteshin, arrestoheshin dhe dënoheshin shqiptarët në ish-Armatën jugosllave dhe nuk pati fare reagime. Shqiptarët që punonin, studionin apo jetonin jashtë Kosovës ishin vënë, nën kërcënim dhe presion, në situatë që, ose të burgosen, ose të bashkëpunojnë me autoritetet jugosllave dhe serbe. Presionin e bënë së bashku me udhëheqjen shqiptare të asaj kohe të cilët edhe në kohën e krahut të luftës jetuan më mirë se në kohën e Millosheviqit që i shërbyen me shumë zell. Bijtë

dhe bijat e tyre sot jetojnë dhe paguhen më mirë se çdo fëmijë i një veterani të luftës, dëshmorit, të persekutuari politik apo një tjetri. Edhe popët e Shën Exhidios bënë presion të nënshkruhej Marrëveshja për Arsim duke e ulur këtë të drejtë nën nivelin e autonomisë kulturore dhe askush nuk reagoi. U bë një presion i madh kundër atyre që kundërshtuan Konferencën e Rambujesë e cila, po të nënshkruhej nga Serbia dhe Millosheviqi, do ta legalizonte robërinë me këtë marrëveshje ndërkombëtare ose do të siguronte një autonomi kulturore. Kështu, jo pse ishin shumë të mençur ata që nënshkruan Marrëveshjen e Rambujesë sa ishin të marrë dhe budallenj ata që nuk e nënshkruan, Serbia dhe Millosheviqi. Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake në Kumanovë e nënshkruan pa na pyetur fare, kurse nën kërcënim dhe shantazh e demilitarizuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës duke ia zëvendësuar pushkallat me kazma dhe lopata.

Nën kërcënim i organizonin zgjedhjet e Serbisë në Kosovë sikur që me kërcënim i bënë Zonat e Mbrojtura. Me kërcënim e bënë Marrëveshjen e Vjenës dhe na imponuan kriminelin kushtetues, Mati Ahtisari, i cili vetëm e përligji gjendjen e krijuar në terren duke e bërë një pavarësi të kushtëzuar, shantazhuar dhe me invaliditet të rëndë. Pasojat e saj i vuajmë edhe sot duke na detyruar të pranojmë bisedime edhe për tema që do të duhej të kishin përfunduar në qershor 1999 dhe përfundimisht të hidhen qoftë edhe si ide në vitin 2018. Me kërcënim e bënë decentralizimin në vija etnike, me kërcënim na imponuan flamurin e Tinës, himnin e Evropës, ndërkohë që na trajtuan dhe po na trajtojnë si shtetin më të zgjebosur dhe lebroz, na e imponuan Kosovën shumetnike. Me kërcënim dhe shantazh e ndanë Veriun e Kosovës duke i lënë nën okupim Serbisë. Me kërcënim e pastruan Veriun e Kosovës duke vrarë dhe përzënë shumë shqiptarë dhe joserbë ashtu

sikur ne shqiptarët që përzëmë serbët nga disa qytete brenda Kosovës.

Me kërcënim dhe shantazh na e imponuan Kushtetutën me të cilën serbët trajtohen si “nebeski narod - popull hyjnor” dhe po kjo Kushtetutë nuk na mundëson ta bëjmë edhe as një pordhë të vetme pa pëlqimin e 2/3 të serbëve.

Na kërcënuan dhe shantazhuan se duhet ta pranojmë formulën idiote “Standardet para statusit” sikur që na detyruan që masakrimin juridik të kriminelit kushtetues, Mati Ahtisari, ta pranojmë si Kushtetutën më demokratike në botë.

Me kërcënim të Pushikarit dhe ambasadorit Dell dhe me disa politikanë të korruptuar të krahut të luftës, u eliminua nga mundësia e të bërit president ATE që tërë jetën ia kushtoi popullit, shtetit, lirisë dhe bashkimit kombëtar, i papërsëritshmi Baca Adem Demaçi, për ta zgjedhur president njeriun që me asgjë nuk e meritoi këtë post, ose më mirë ta them, personi i fundit në botë që duhej të bëhej president i Kosovës, Gjet Macolli.

Me kërcënim dhe shantazh na e imponuan Bech Dell Enkën, Procreditin, Monako Telekomin, faljen e aseteve përmes mendermethënë procesit të privatizimit shteteve që investonin në Serbi, kurse fitonin në Kosovë.

Me dhunë na i plaçkitën 20 vjet paratë e xhepit për t’ua paguar rrymën, ujin, mbeturinat dhe shërbimet serbëve të Ahtisarit.

Po të mos e votonin demarkacionin me Malin e Zi, na kërcënuam se do të na përjashtonin nga Evropa dhe bota duke shkaktuar shumë përçarje dhe dhunë brendashqiptare dhe, si kundërvlerë, na premtuan liberalizimin e vizave. E bëmë këtë duke e gjymtuar territorin e Kosovës dhe si shpërblim fituam “të trashtë e surrlës”.

Në rrethana të një terrori psikologjik dhe nën kërcënime të vazhdueshme na detyruan ta votojmë një Gjykatë raciste dhe fashiste siç është Gjykata Speciale. As pigmejtë e Afrikës nuk do ta bënin këtë. Sot ka filluar një pendim, por se është vonë. Nuk është dëm se mund të dënohen disa individë, por se edhe pas 500 e më shumë vitesh do të figurojë se ishte formuar një gjykatë që ka dënuar kriminelët shqiptarë e që paskan vrarë serbë të pafajshëm në kohën kur raporti i të vrarëve janë 85-89 për qind shqiptarë të vrarë nga serbë të pafajshëm dhe afërsisht 3-4 për qind serbë të vrarë nga kriminelët shqiptarë. Kështu e thotë kjo Gjykatë.

Tash së fundmi po na kërcënojnë t’ia kthejmë bythët Grenellit dhe të pranojmë çdo gjë që ai kërkon i shtyrë nga perversiteti dhe sadizmi i tij. Se kështu paska kërkuar edhe Donald Tramp. Dhe pikë,

askush nuk guxon të kundërshtojë sepse menjëherë del të jetë antiamerikan. Çfarë idiotizmi dhe çfarë nënshtrimi i pa kusht që kërkohet nga Albin Kurti dhe nga të tjerët që, jo se e përkrahin Albinin, por se kjo është bindje e tyre! Nëse kërkohet që menjëherë të hiqet taksa 100 për qind për mallrat serbe, të mos vendoset asnjë lloj reciprociteti, të vazhdohet me bisedime për një marrëveshje përfundimtare ku do të duhet të merren vendime të dhimbshme, por të guximshme dhe që nuk ka asnjë kushtëzim të ngjashëm për Serbinë, a ju duket kjo e drejtë, e dinjitetshme dhe e pranueshme për ata që dinjitetin, së paku e kanë në gjurmë e lëre më që dikush këtë e ka vullnet, besim dhe qëndrim! Po siç mundet të silllet në mënyrë aq të paturpshme Grenell kur, në të njëjtën kohë kur tregohet vullnet nga kryeministri Kurti, ministri për Punë të Jashtme i Serbisë, Gjet Macolli, më falni Ivica Daçiqi (për kah rezultati i çnjohjeve nuk dallojnë aspak, janë një) e përplas para gazetarëve notën e Sierra Leones për çnjohje të pavarësisë së Kosovës. Dhe nuk ka asnjë reagim nga ndërkombëtarët, Robespieri (Glauku) vajton dhe premtun se do të kërkojë ndihmë nga ShBA-ja dhe BE-ja në kohën kur Aleksandar Vuçiqi, kryetari çetnik i Serbisë, botërisht deklaroi se nuk ka asnjë kërkesë nga ShBA-ja ta ndalë fushatën për çnjohje, kurse Evropa i ndihmon shumë Serbisë në këtë proces. Nuk më ka rënë të lexojë se ka çnjohje në praktikën ndërkombëtare, por se ka pezullim apo ndërprerje të përkohshme të marrëdhënieve diplomatike. Nëse ia kthejmë bythën Grenellit nuk duhet ta bëjmë pa na treguar se çka fitojmë apo çka na pret pas kësaj! Latinët e lashtë thoshin: “conti pari, amici kari..” (llogaritë e pastra, miqësia e përjetshme)!

Po çka mendohet të hidhet në tavolinë:

1. Korrigjimi i kufijve: Ky është varianti më idiot dhe më i dëmshëm për Kosovën me ç’rast Serbia do ta merrte Veriun e Kosovës (trurin e trupit të Kosovës) dhe do t’i jepte disa xhamia dhe djerrina të Luginës që nuk vlejnë as pesë para. Serbia kurrë nuk do të pranonte që Kosovës t’i japë tërë Luginën si njësi kadastrale. Përveç se do ta merrte veriun, do ta qethte edhe territorin e Anamoravës, Serbia do të linte nja 13 mina të kurdisura brenda Kosovës (Zonat e Mbrojtura) e që do t’i aktivizonte gjithnjë kur do të kishte nevojë. As shqiptari më i marrë nuk do të duhej të diskutonte për këtë e lëre më të rikrijonte harta të reja. Kosova duhet të bisedojë vetëm brenda kufijve ekzistues me të cilët është njohur nga mbi 100 shtete sikur edhe nga ShBA-ja. Nëse

kjo ndarje imponohet me ndonjë blick krig (luftë e shpejtë dhe e kontrolluar) atëherë do të ketë shpërngulje masive (të dhunshme) nga brendia e Kosovës dhe do ta shkaktonte efektin domino me ç’rast shqiptarët dhe Shqipëria do të duhej ta kërkonin bashkimin e trojeve shqiptare duke prekur kufijtë e të gjitha shteteve ballkanike. Prandaj, po them se vetëm kufijtë ekzistues janë zgjidhje, ndërsa ndërkombëtarët kanë mundësi dhe detyrim t’i përcjellin të drejtat e pakicave dhe, në rast se ato nuk respektohen, të vendosin sanksione përkatëse.

2. Zajednica apo komunat me shumicë serbe, nëse bëhet sipas kërkesës së Serbisë dhe Marrëveshjes së Brukselit, e përligj ndarjen e brendshme të Kosovës në vija etnike duke e krijuar një situatë sikur në Bosnje e Hercegovinë dhe duke e bërë Kosovën jofunksionale. Ky variant pashmangshëm dërgon në referendum dhe ndarje të Kosovës.

3. Ahtisari Plus: Është Zajednica Plus apo statusi që i pëlqen Grenellit dhe Borellit; një gjendje midis pavarësisë dhe autonomisë ku 90 për qind do të ishte pavarësi për serbët dhe 10 për qind autonomi. Projekt shumë i rrezikshëm dhe i rafinuar që lë përshtypje se kjo do të mbetet nën sovranitetin e Kosovës. Mashtrim optik dhe idiotik! Dhe,

4. Sigurimi i korridorit të lirë për Serbinë në trajektoren Serbi-Durrës (Shqipëri) përmes Kosovës ku autostradat e Kosovës do të bëheshin “amë e thiut” e që ka qenë ëndërr e Jovan Cvijiqit, Garashaninit, Nikolla Pashiqit, Ivo Andriqit, Josip Broz Titos, Aleksandar Rankoviqit dhe Slobodan Millosheviqit. Dalja në det ka qenë ëndërr e përealizuar e këtyre serbomëdhenjve, kurse një i Rekës (lugat), nëse është cituar drejt, paska deklaruar se ky qenka kompromisi i duhur me Serbinë. Në të njëjtën kohë nëse do të realizohej, me një të rame, “korridori i lirë” shkërdhenë pavarësinë e dy shteteve, të Kosovës dhe të Shqipërisë. O Zot, fali këta injorantë se, po të kishin mbaruar vetëm dy klasë filllore politike, do të gjykonin më arsyeshëm dhe më drejt! Nëse ky i Rekës vërtet mendon kështu atëherë le të dërgojë buqetë me lule te varret e Cvijiqit, Garashaninit, Pashiqit, Andriqit, Titos, Rankoviqit, Millosheviqit dhe Esat Pashë Toptanit. I ka krejt në një vend, në Beograd të Serbisë!

A do të bjerë Qeveria Kurti: Para zgjedhjeve të fundit ndërkombëtarët ushtronin ndikim që në Kosovë të ketë ndryshime përmes mekanizmave që zakonisht përdoren për këtë; shoqërisë civile, mediave elektronike dhe të shkruara, personaliteteve me

“autoritet dhe besueshmëri”, sondazheve të porositura etj. Ndërkombëtarët e përjashtuan çdo mundësi që krahui i luftës të qëndrojë në pushtet duke ua lëshuar mbi kokë dhe Gjykatën Raciste Speciale dhe, pas certifikimit të rezultateve, i tërë presioni shkoj në drejtim të koalicionit LV-LDK, ndonëse këto dy subjekte politike ishin diametralisht të kundërta. Akuzoheshin disa kapës të shtetit, kurse faleshin kapës të tjerë që u bënë pjesë e pushtetit aktual. Koalicioni aktual kishte moto luftimin e korrupsionit, krimin të organizuar, hapje të reja të vendeve të punës për një zhvillim efektiv, reforma të thella në arsim, shëndetësi, ekonomi dhe politikë të jashtme. Të gjitha këto premtime dhe zotime elektorale ishin në linjë të plotë me kërkesat ndërkombëtare. Premtuan se do ta largojnë taksën të cilën do ta zëvendësojnë me reciprocitet 100 për qind. Dhe këtu u bë lidhja e shkurtër me ndërkombëtarët të cilët kërkonin heqjen e taksës pa asnjë kusht, eliminimin e çdo përpjekje për reciprocitet me Serbinë, si kushte për vazhdim të bisedimeve, pa dhënë asnjë zotim konkret. Me një fjalë, Kosovës kushte, ndërsa Serbisë asnjë kusht. Albin Kurti e bëri publik një dinamikë kohore për heqje të taksës 100 për qind duke e mbushur armën politike me reciprocitet pas së cilës, fillimisht nga Grenell u refuzua dhe u kërcënua e që ishte e mjaftueshme që kryeministri Kurti të akuzohej për antiamerikanizëm dhe rrezikim të marrëdhënieve me amerikanë. Kësaj valle iu bashkëngjit edhe partnerja e koalicionit, LDK-ja, që në rastin më të butë mund të cilësohet si e pandershme. Në çdo vend të botës është një periudhë 100-ditore e qeverisjes pas së cilës mund edhe të bëhen edhe matjet e para për cilësinë e qeverisjes. Kjo periudhë e “besës” nuk po respektohet në Kosovë dhe po përdoret sulmi nën brez për ta rrëzuar qeverinë Kurti. Jo për shkak të qeverisjes së keqe, por për shkak të një antiamerikanizmi hipotetik! Skajshmërisht e pandershme dhe politikisht e papranueshme. Qeveria Kurti ka problem me dialog për faktin se po e trashëgon një “vrëmë të zezë” të bisedimeve të Brukselit e sidomos është një paqartësi me fushatën arrogante, agresive, kushtëzuese dhe të pamoralshme të Grenellit që nuk po lë fare hapësirë as vepruese e as kohore për bisedime por, të mbështetur për muri, na e futë nën turin ndonjë marrëveshje të Thaçit dhe Vuçiqit e cila nuk është e mirë për Kosovën. Po të ishte e mirë, i pari do të dilte Hashim Thaçi me këtë marrëveshje. Në çdo variant, fitues është dhe do të jetë Serbia dhe Vuçiqi me vetë faktin se e kanë imponuar në

bisedime temën e statusit të Kosovës dhe tërësisë territoriale. Pikërisht kësaj i druhet kryeministri Kurti sepse, tani, përkundër kohës kur ishte në opozitë, ka informata të dorës së parë për bisedime dhe rezultat eventual përfundimtar. Mirëpo, ose do të përballlet me këtë përbindësh që po e gërryen Kosovën territorialisht dhe politikisht, ose do të eliminohet nga skena politike apo, siç tha një analist ndërkombëtar, “do t’u hidhet qenve”. Çdo marrëveshje që arrihet shpejt e shpejt nuk mund të jetë e mirë dhe nuk duhet të nënshkruhet. Fjalët se asnjë marrëveshje nuk mund të nënshkruhet pa kaluar nëpër Kuvend janë përralla pa kripë për faktin se ndërkombëtarët do ta sajojnë një përbërje të Kuvendit për ta votuar marrëveshjen dhe nuk nguten fare. Duhet ta kemi të qartë se edhe Marrëveshja më e lodhët ndërkombëtare është mbizotëruese mbi të gjitha ligjet e vendit dhe mbi vetë Kushtetutën. As unë aspak nuk i besoj Grenellit, por nuk jam antiamerikan. Nuk është fare e domosdoshme që shqiptarët t’i binden Grenellit dhe Trampit sepse lehtësisht mund të ndodhë që pastaj t’u digjen buzët dhe t’u dhembë prapanica. Albin Kurti duhet të kritikohet nëse nuk iu përmbahet premtimeve elektorale dhe, në këtë bazë, edhe mund të rrëzohet qeveria Kurti, por në asnjë mënyrë nuk duhet të rrëzohet pse nuk i bindet Grenellit, Borrellit apo Trampit duke ia veshur, të mbërthyer këmishën e antiamerikanizmit. Amerikanët dhe BE-ja, nëse duan, lehtësisht e rrëzojnë qeverinë Kurti jo përmes opozitës, por me ndihmën e partneres qeverisëse, LDK-së. Albin Kurti mandatin për qeverisje e ka fituar me duar të pastra, me premtime se do ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, se do të bëjë reforma të thella në ekonomi, shëndetësi, drejtësi, arsim dhe politikë të jashtme, standarde dhe vlera demokratike të vendosura pikërisht nga ShBA-ja dhe BE-ja. T’i japim kohë të mjaftueshme qeverisë Kurti dhe vetëm atëherë, në bazë të rezultateve, mund të kërkojmë përgjegjësi për dështime eventuale, nëse ka rezultate pozitive duhet të përkrahet. Për Kosovën shumë me rëndësi është të ketë përparime pozitive në fushat e lartpërmendura se një arritje e shpejtë e një marrëveshjeje me Serbinë e që pastaj do të kishte problem zbatimi. Mënyra e qeverisjes duhet të jetë element përcaktues për rrëzimin eventual të qeverisë Kurti e jo antiamerikanizmi apo mosbindja ndaj Grenellit, Borrellit apo Trampit. Këto janë argumente të shpifura, moralisht të papranueshme dhe politikisht të dëmshme!

Trumpi nuk do të shkojë në Moskë për shënimin e Luftës së Madhe Patriotike

MOSKË, 10 MARS - Kremlini ka thënë se presidenti amerikan, Donald Trump, ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në festimet për përvjetorin e 75-të të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, që në Rusi njihet si Lufta e Madhe Patriotike. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov u ka thënë gazetarëve në Moskë se ende nuk është bërë e qartë kush do të përfaqësojë Shtetet e Bashkuara në këtë organizim. "Ne jemi

informuar nga kanale diplomatike që presidenti Trump nuk do të marrë pjesë", ka thënë Peskov. Për nder të kësaj ngjarjeje, në Moskë më 9 maj do të zhvillohet një paradë ushtarake. Moska ka thënë më herët se përveç Trumpit, ka ftuar edhe kryeministrin britanik, Boris Johnson, liderin verikorean, Kim Jong, liderin kinez, Xi Jinping dhe zyrtarë të kombeve të tjera.



Bideni përballë Sandersit, zgjedhje paraprake në 6 shtete

Gjashtë shtete zhvilluan të martën votime që do të ndihmojnë në përcaktimin e delegatëve për në kuvendin e demokratëve, që do të jetë një provë me rëndësi në garën tashmë mes dy kandidatëve - ish-nënpresidentit Joe Biden dhe senatorit të Vermontit, Bernie Sanders

UASHINGTON, 10 MARS - Në garën presidenciale demokrate filloi të martën një tjetër raund i zgjedhjeve paraprake - një provë me rëndësi në garën tashmë mes dy kandidatëve - ish-nënpresidentit Joe Biden dhe senatorit të Vermontit, Bernie Sanders. Gjashtë shtete zhvillojnë të martën votime që do të ndihmojnë në përcaktimin e delegatëve për në kuvendin e demokratëve. Ish-nënpresidenti Joe Biden bëri fushatë në Mississippi - duke kërkuar të zgjerojë epërsinë e tij në garën demokrate të martën. "Vërtet besoj se kemi krijuar një moment dhe lëvizje, të fuqizuar nga shtylla dhe baza e Partisë Demokratike, një lëvizje që do të mposhtë Donald Trumpin dhe do të rivendosë shpirtin e këtij kombi", tha ai. Bideni mori mbështetjen e dy ish rivalëve, senatorit të Nju Xhersit Cory Booker dhe senatores të Kalifornisë Kamala Harris. Rivali kryesor i mbetur i Bidenit, senatori i Vermontit, Bernie Sanders, mori mbështetjen e udhëheqësit të të

drejtave civile Jesse Jackson ndërsa bëri fushatë në Miçigan. "Pra, vëllezër dhe motra, le të shkojmë përpara dhe të fitojmë të martën, le ta fitojmë emërimin, ta mposhtim Trumpin dhe ta transformojmë këtë vend! Shumë faleminderit të gjithëve!", tha Sandersi. Sandersi gjithashtu vazhdoi të ankohet se rryma tradicionale e partisë është bashkuar për ta ndaluar atë. Pyetja me të cilën preokupohet media është se si mund ta ndalim Bernie Sanders? Duhet të ndalim koronavirusin dhe të ndalim Berne Sanders. Çfarë gjëje e tmerrshme. Kthimi dramatik i Bidenit në garën demokrate javën e kaluar, tërhoqi gjithashtu vëmendjen e presidentit Donald Trump. "Isha i përgatitur të përballesha me Bernin. Pastaj thashë, nuk mendoj se do të përballem me Bernin. Mendoj se do të jetë shumë e vështirë për të, të fitojë", tha ai. Bideni fitoi dhjetë nga 14 zgjedhjet paraprake javën e kaluar në Super të Martën dhe riformatoi plotësisht garën



demokrate, thotë Larry Sabato. "Më pëlqen të them se Bidenit iu dha një mundësi gati e pabesueshme pasi ai u ngrit nga hiri dhe arriti t'i habisë të gjithë dhe të fitojë kaq shumë zgjedhje paraprake me një diferencë të lartë në shumicën e rasteve", tha ai. Suksesi i Bidenit detyroi

largimin e dy rivalëve nga gara - ish-kryetarit të Bashkisë së Nju Jorkut Michael Bloomberg dhe senatores së Masaçusets Elizabeth Warren. Shansi më i mirë i Sandersit për të rimarrë vrullin mund të vijë të martën në zgjedhjet paraprake të Miçiganit, thotë Jim Kessler. "Nëse Bernie nuk

shënon një fitore të madhe në Miçigan, do të filloni të shihni fundin e kandidaturës së tij, dhe mendoj se atëherë do të jetë e qartë", thotë Jim Kessler. Përveç Miçiganit, Ajdwho, Misisipi, Mizuri, shteti i Uashingtonit dhe Dakota e Veriut zhvillojnë të martën zgjedhje paraprake.

Parlamenti rus ia mundëson Putinit rizgjedhjen në postin e presidentit

MOSKË, 10 MARS - Dhoma e Ulët e Parlamentit të Rusisë miratoi ndryshimin kushtetues që i lejon presidentit Vladimir Putin të kandidojë për një mandat të ri, më 2024. Derisa po zhvillohej debati në parlament, presidenti rus, Vladimir Putin, tha se pajtohet me ndryshimin kushtetues, vetëm nëse propozimi miratohet nga Gjykata Kushtetuese. Më herët, ligjvënësja ruse, Valentina Tereshkova, e par-

tisë në pushtet Rusia e Bashkuar, ka propozuar ndryshime në Kushtetutë që do t'ia lejonin presidentit Vladimir Putin të kandidojë përsëri. Mandati i tij aktual përfundon më 2024. Në janar, Putini, i cili që prej vitit 2018 po ushtron mandatin e tij të fundit gjashtëvjeçar, siç lejohet nga kushtetuta aktuale, bëri thirrje për një seri ndryshimesh kushtetuese të cilat kanë për qëllim një

ristrukturim të madh të kompetencave ligjore midis presidencës dhe parlamentit. Besimi i rusëve në presidentin e tyre, Vladimir Putin, ka rënë në dy vjetët e fundit, duke shënuar shifrën më të ulët prej vitit 2013, një vit pasi ai ishte kthyer nga kryeministria në presidencë. Sondazhi i publikuar më 12 shkurt nga Qendra Levada tregon rënie të popullaritetit të Putinit, i cili është lideri më i famshëm politik në Rusi nga viti 2000.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Shijo
Pranverën
me...





ORIANA FALLACI

LETER E ORIANA FALLACIT PËR PIER PAOLO PASOLININ

Kjo letër e Oriana Fallacit na ndihmon të njohemi më mirë me shkrimtarin e madh italian Pier Paolo Pasolini. Letra i ishte drejtuar poetit pas vdekjes dhe brenda saj Fallaci ngjall fjalë, mendime dhe emocione që poeti i kishte lënë asaj në disa letra. Pra, kjo letër është një dokument i çmuar që na jep një portret të vërtetë të autorit

“Diku, Pier Paolo, përzier me letra, gazeta dhe shënime, duhet ta kem letrën që më shkrove një muaj më parë. Atë letër mizore, të pamëshirshme, që më goditi me të njëjtën dhunë me të cilën të vranë. E barta me vete, për dytri javë rresht, në gjysmën e botës, deri në Nju Jork, pastaj e vendosa, nuk e di se ku dhe po e pyes veten nëse një ditë do ta gjej përsëri. Shpresoj jo. Po ta shikoj dhe lexoj edhe një herë do të më lëndojë po aq sa atëherë kur e lexova dhe u mërzita duke i fiksuar fjalët, me shpresë që t'i harroja. Por, ja që s'i harrova. Mund t'i rindërtoj përmendsh pothuajse. Pak a shumë kështu:

“E mora librin tënd të fundit. Të urrej që e ke shkruar. Nuk shkova përtej faqes së dytë. Nuk dua ta lexoj kurrë. Nuk dua të di se çfarë ka barku i një gruaje. Më neverit mëmësia. Më fal, por unë atë neveri e bart me vete që kur isha fëmijë, kur isha tri vjeç, më duket ose, ndoshta, ishin gjashtë kur dëgjova nënën time të pëshpëriste se...”

Nuk t'u përgjigja. Çfarë ti përgjigjesh një burri që vajton

dëshpërimin e tij pse është burrë, dhimbjen e tij pse ka lindur nga barku i një gruaje? Nuk ishte letër e drejtpërdrejtë për mua, në fund të fundit, por për veten tende, për vdekjen që gjithmonë të ndiqte për t'i dhënë fund zemërimit të të ardhurit në këtë botë falë një barku të fryrë, dy këmbëve të hapura, një kordoni kërthizor të zgjidhur në gjak. Si mund të ngushëlloj të pajtohesh me një pashmangshmëri të tillë? Fjalët që të ngushëllonin ishin në librin që e refuzove me zemërim. E vetmja mënyrë për të të qetësuar do të të kishte qenë të të merrja në kraharor: të të doja sikur vetëm një grua që di ta duaj një burrë. Por ti kurrë s'e lejove një grua të të marrë në kraharor, që të dojë. Ai barku ynë nga i cili ke dalë, të ka mbushur gjithnjë me tmerr. Me përjashtim të nënës tënde e cila u nderua si një Mari e mbetur shtatzënë nga Fryma e Shenjtë, duke harruar që edhe ti ishe i lidhur me një kordon kërthizor që zgjidhej në gjak. Ne gratë të kemi nxitur fizikisht një neveri.

Kur na pranoje e bëje nga keqardhja. Nëse na falje ishte për vullnet. Në çdo rast nuk harroje asnjëherë legjendën që na fajëson që kemi këputur mollën, zbuluar mëkatin. E urreje shume mëkatin, seksin, që për ty ishte mëkat. E doje shumë pastërtinë, dëlirësinë që për ty ishte shpëtimi. Dhe sa më pak pastërti gjeje, aq më shumë hakmerreshe duke kërkuar ndyrësi, vuajtje, vulgaritet: si ndëshkim. Si disa priftërinj që marrin kamxhik, e kërkoje atë me seks, që ishte mëkat për ty. Seksi urrejtës i djemve me fytyra të paqarta (ti që kishe kultin e inteligjencës), me trupin pa asnjë hir (ti që kishe kultin e hirit), nga mendja pa bukuri (ti që kishe kultin e bukurisë).

Në ato u zhyteshe, e poshtëroje veten, e humbje veten; sa më të vrullshme të ishin, më famëkeqe ishin. Për ato këndoje në poezitë e tua të bukura, librat e tu të bukur, filmat e tu të bukur. Nga ato ëndërroje të vriteshe, herët a vonë, për ta përmbushur vetëvrasjen tënde. A jam e keqe ti them këto? A jam mizore edhe unë? Ndoshta, por ishe ti ai që më mësove se duhet të jemi të singertë edhe me koston e paraqitjes si të këqij, të singertë, me koston e të qenit mizor dhe, gjithmonë, të guximshëm të themi atë që besojmë; edhe nëse është e pakëndshme, skandaloze, e rrezikshme. Ti ne shkrime fyeje, duke plagosur

deri në pikën ku thyhet zemra. Dhe unë nuk të fyej duke të thënë se nuk ishte ai shtatëmbëdhjetëvjeçari që të vrau; ti je ai që ke bërë vetëvrasje duke e përdorur atë. Nuk të lëndoj kur them se gjithherë e dija që ti po e thërrisje vdekjen sikur të tjerët që thërrisnin Zotin, që dëshiroje vrasësin si të tjerët që dëshironin parajsën. Ishe aq fetar ti që prezantoheshe si ateist. Kishe njëfarë nevojë për absoluten ti që na fiksoje me fjalën njerëzim. Vetëm duke përfunduar me kokë të thyer dhe trup të shqyer ti mund ta shuaje ankthin dhe ta kënaqje etjen tënde për liri. Dhe nuk është e vërtetë që e urreje dhunën. Me tru e dënoje, por me shpirt e kërkoje, si mënyrë të vetme për të kënaqur dhe ndëshkuar djallin që digjej brenda teje. Nuk është e vërtetë që mallkoje dhimbjen.

Përkundrazi, të shërbente si një brisk për ta nxjerrë engjëllin që ishte në ty. E vura re nga takimi i parë kur u takuam në Nju-Jork: tani, dhjetë vjet më parë. Dhe ky fakt më bëri përshtypje më shumë sesa gjeniu yt ngazëllyes, kultura jote irrituese, fantazia jote e ndezur. Vrapoje çdo natë në lagjet ku as policët nuk guxojnë të hyjnë të armatosur. Asnjëherë nuk u lodhe së sfiduari turbullirën, së prekuri tmerrin, së bashkuari me rrënojat mashkullore të varësve të drogës, të përmbysurve, të dehurve.

Pavarësisht nëse shkoje në Bowery o Harlem ose në port, gjithmonë ishe i pranishëm atje ku kishte të keqe dhe rrezik. Arthur Rimbaud, në krahasim me ty, bëhej edukator. Sa herë kam pasur frikë se mos po më thonë që të kanë gjetur me fyt të prerë apo me ndonjë plumb në zemër. Një mbrëmje edhe ta thashë. Ishim para Qendrës Lincoln dhe po kërkoje një taksì për të shkuar në një vend që nuk doje ta pranoje. Nga padurimi dukeshë i shqetësuar, dridheshe. Pëshpërita: “Do ta presin fytyrën, Pier Paolo”. E ti më vështroje me sy të ndritshëm dhe të trishtuar (sytë e tu ishin gjithnjë të trishtuar, madje edhe kur qeshje), pastaj u përgjigje me ironi: “Po?”. Te kujtohen, vërtet, ato ditë në Nju-Jork? Vije në banesën time, uleshe në divanin e vjetër, kërkoje një Coca-Cola (kurrë nuk të pashë të dehur) dhe më thoshe që e doje Nju-Jorkun sepse ishte i ndotur, pa shpirt. Në atë qytet të jashtëzakonshëm shikoje vetëm mjerimin moral, si një ish-koloni thoshe, si një nënklasë, e një varfëri që e krahasoj me varfërinë e Kalkutës, Casablanca, Bombay.

Një pasdite më the: “Më vjen keq që nuk erdha këtu më parë, 20 ose 30 vjet më parë, për të qëndruar. Nuk më kishte ndodhur kurrë që të bie kaq në dashuri me një vend. Përveç në Afrikë, ndoshta! Por në Afrikë do të doja të shkoja dhe të qëndroja

në mënyrë që të mos vritem. Po, Afrika është sikurse një drogë që merr kundër vetëvrasjes. Nju-Jorku, përkundrazi, është një luftë në të cilën ballafaqon vetëvrasjen”. Kishe ardhur nga Montreali me tren. Kishe zbritur në një stacion nëntokësor dhe nuk kishe gjetur një transportues. Me valixhet që t’i shtypnin krahët kishe kapërcyer një tunel dhe, në fund të tunelit, kishte parë një dritë verbuese. Qyteti të kishte sulmuar me lavdinë e një shfaqjeje: Jerusalemi që shfaqet në sytë e një kryqëzori, thoshe. Ndërsa rrokaqiejt i shihje si Dolomitët, e unë të dëgjoja kapluar nga frika: ishe vetëm poet apo edhe i çmendur? Asnjëherë nuk kam menduar që Nju Jorku mund të shihet si Jerusalem dhe rrokaqiejt si Dolomitët. Por në majë të atyre rrokaqiejve nuk deshe të ngjiteshe asnjëherë. Sa herë u përpoqa t’ju çoj në katin e fundit të Empire State Building! Të premtoja: “Është si të ngjitësh në një majë malore, era është e pastër atje”. Gjithmonë gjeje një justifikim: ty nuk të interesonte era e pastër. Të interesonte krenaria e Rrugës Dyzet e dy, me dritat e saj të kuqe nga ferri dhe dyqanet që shisnin pornografi.

“Dje, në rrugën Dyzet e dy, pashë një njeri që po vdiste. Në duar kishte një pako. E fiksoi dhe pastaj e përplasi për tokë me aq zemërim saqë paketa u prish. Pastaj ai njeri u mbështet për muri, rrëshqiti ngadalë në tokë dhe qëndroi aty: të vdiste. Pa u ndalur askush ta shikojë, ta ndihmojë. As unë. A është kjo e keqe? A është mungesë e keqardhjes? Ndoshta është një formë superiore e mëshirës. E kupton, me i lënë të tjerët të vdesin”.

Ne menjëherë u bëmë miq, ne miqtë e pamundur. Dmth., unë gruaja normale dhe ti burri anormal, të paktën sipas kanoneve hipokrite të të ashtuquajturit civilizim. Unë jam e dashuruar me jetën dhe ti i dashuruar me vdekjen. Unë kaq e repretë dhe ti kaq i ëmbël. Kishte një ëmbëlsi femërore tek ti, një mirësi femërore. Edhe zëri yt si të tjerët kishte një diçka femërore dhe kjo ishte e çuditshme sepse tiparet tua ishin tiparet e një burri: të thatë, të egër. Po, kishte një egërsi të fshehur në mollëzat e tua të forta, në hundën tënde si të bokserit, në buzët tua të holla, një egërsi e paligjshme. Dhe ajo transmetohej në trupin tënd të vogël dhe të hollë, në tiparet tua mashkullore, të mbytura, nga një kafshë që kërcen dhe kafshon. Por, kur flisje, buzëqeshje apo lëvizje duart, bëheshe po aq i butë si një grua, i mirë si një grua. Dhe unë ndihesha gati në siklet që provoja atë transport misterioz për ty. Mendoja, në fund të fundit, është njësoj si ndjenja e tërhequr nga një grua. Si dy gra, jo një burrë dhe një grua, shkonim për të blerë pantallona për Ninetto, xhaketa për Ninetto, dhe ti flisje për të sikur të ishte djali yt: i lindur nga barku yt, dhe jo i mbjellë nga fara jote. Sikur të

ishe xheloz për amësinë kur qortoje nënën tënde. Për Ninetto, në një dyqan në fshat, u dashuruar në një këmishë që ishte kopja e saktë e këmishëve të përdorura nga Sing Sing. Në xhepin e majtë shkruhej: “Burgu i Shtetit. Galeotto numër 3678”. E provove duke përsërit vazhdimisht: “E lezetshme, do ta pëlqejë”. Pastaj dolëm jashtë dhe në rrugë pati një procesion në favor të luftës në Vietnam, të kujtohet? Tipa të moshës së mesme ngriteshin shenja mbi të cilat shkruhej “Bombardoni Hanoi”, u ndjeve keq. Për një javë ke qenë në ankth duke më shpjeguar se momenti i vërtetë revolucionar nuk ishte në Kinë apo në Rusi, por në Amerikë. “Shko në Moskë, shko në Pragë, shko në Budapest dhe mendon se atje revolucioni ka dështuar: socializmi ka vënë një klasë në pushtet dhe punëtori nuk është mjeshtër i fatit të tij.

Shko në Francë, në Itali dhe e kupton që komunisti evropian është një njeri bosh. Vjen në Amerikë dhe zbulon të majtën më të bukur që mund të zbulojë një marksist si unë. Revolucionarët këtu sjellin në mend të krishterët e parë, në ata ekziston i njëjti absolutet i Krishtit. Më erdhi një ide: transferimi i filmit tim për Shën Paolon në Amerikë”.

Nga kultura amerikane zgjidhje pothuajse gjithçka, por sa vuajte kur dy studentet amerikane të pyetën se cili ishte poeti yt i preferuar, e ti iu përgjigje, natyrisht Rimbaud, dhe ato të dyja injoruan se kush ishte Rimbaud. Është kjo arsyeja pse u largove nga Nju-Jorku kaq i pakënaqur? Unë do të thosha jo. Unë do të thosha që e le Nju-Jorkun i zhgënjyer, sepse nuk kishe vdekur, sepse shikove jashtë shkurajimit dhe nuk u përmyse. Netët e kaluara në kërkim të vetëvrasjes ti kishin bërë vetëm mollëzat e faqeve më të egra, shikimin më të etshëm. Po ndihem, thoshe, si një fëmijë, të cilit ia kanë ofruar një tortë dhe më pas ia kanë marrë, ndërsa ishte gati ta kafshonte. Po, do të duhej të pinit një mijs hidhërime të tjera përpara se të gjenit diçë që do t’jua jepte dhuratën e vrasjes, t’jua dhurojë një vdekje koherente pas një jete koherente. Thonë që ti ishe i aftë të ishe gazmor, zë lart dhe se për këtë iu pëlqeu shoqëria me të rinj: të luaje futboll, për shembull, me djemtë e fshatrave. Por unë kurrë nuk të kam parë kështu. Melankolinë e bartje sipër si një parfum dhe tragjedia ishte situata e vetme njerëzore që ti me të vërtetë e kuptoje. Nëse një person nuk ishte i lumtur, nuk ju interesonte. Kujtoj me çfarë dashurie, një ditë, u përkulët para meje, ma shtrënguat kyçin e dorës dhe pëshpëritët: “As ti, sa i përket dëshpërimit, s’bën shaka!”

Ndoshta kjo është arsyeja pse fati bëri që të takohemi përsëri, vite më vonë. Ishte në Rio de Janeiro, ku kishit ardhur me Maria Callas për pushime. Gazetat shkruanin se ishit të

dashuruar. Ishit? Unë e di që ti dy herë në jetë ke provuar të duash një grua dhe je zhgënjyer. Por nuk mendoj se njëra nga këto dy gra ishte Maria. Ishit shumë të ndryshëm, tepër të ndryshëm estetikisht, psikologjikisht dhe kulturalisht. Në të njëjtën kohë, megjithatë, dukeshit aq të bashkuar nga një bashkëpunim misterioz. Dyshimi im është se ti e kishe adoptuar atë si motër, për ta bërë ta harrojë braktisjen e Aristoteles Onassis. Nuk u shkëpusje asnjëherë prej saj, madje e ndihmoje të vishej dhe zhvishej. Në plazh ia lyeje supet në mënyrë që dielli të mos e skuqte. Në restorante vuaje çdo teke të saj. Gjithmonë indulgjent, i durueshëm, i qetë si infermier në Lambaréné (qyteti i Gabonit, ku Albert Schweitzer themeloi spitalin e vet). Po, ne ty ishte heroizmi i misionarit që shkon për t’i shëruar lebronjtë, mirësia e shenjtorit që vuan martirizimin me gëzim. Një mbrëmje biseduam për të, në detin e Copacabanas, brenda një muzgu të trëndafiltë në të artë. Maria përgjumej mbi rërë, e mbështjellë me një kostum banjash të zi, unë të tregoja për torturat me të cilat brazilianët ushqenin të burgosurit politikë: il pau de arara, elektroskok. Më dëgjoje pa vullnet, pothuajse i irrituar me një bisedë të tillë në një muzg trëndafil në të artë. As nuk më përgjigjeshe. Vetëm kur e kuptove që më lëndove, dhe kur unë t’u vërsula duke të thënë se atëherë ti nuk ishe i singertë në protestat dhe betejat tua, që ishe thjesht një Narcis që pretendon të luftojë kundër padrejtësisë për ta përmbushur kotësinë tënde, filluat të flisnit për Jezu Krishtin dhe Shën Françeskun. Asnjë prift nuk më ka folur asnjëherë si ti për Jezu Krishtin dhe Shën Françeskun. Njëherë e di që më ke pas folur edhe për Shën Agustinin, për mëkatin dhe shpëtimin ashtu siç i shihte Shën Agustini. Ishte kjo kur më recitove përmendsh paragrafin në të cilin Shën Agustini tregon për nënën e vet kur dehej. Në atë rast kuptova që po kërkoje mëkatin për ta gjetur shpëtimin, sigurisht se shpëtimi mund të vijë vetëm nga mëkati dhe sa më i madh është mëkati, aq më çlirimtar është shpëtimi. Ajo që më thoshe për Jezusin dhe për Shën Françeskun, kur Maria përgjumej para detit të Copacabanas, më ka mbetur si një nishan. Sepse ishte një himn për dashurinë kënduar nga një njeri që nuk beson në jetë. Jo rastësisht e kam përdorur në librin që s’deshe ta lexoje.

E futa në gojën e fëmijës kur ai ndërhyr në gjyqin kundër nënës së vet: “Nuk është e vërtetë që ti nuk beson në dashuri, nënë. Beson aq shumë saqë ngulfatesh sepse e sheh kaq pak atë dhe sepse ajo që sheh nuk është kurrë e përsosur. Ti je e bërë nga dashuria. Por a mjafton të besosh në dashuri nëse nuk beson në jetë?” Edhe ti ishe i bërë nga dashuria. Virtyti yt më spontan ishte bujaria. Asnjëherë nuk dije të thoshe jo. Dhuroje

me duar plot cilido që të kërkonte, pavarësisht nëse kishte të bënte me para, punë apo miqësi. Alekos Panagulis, për shembull, i dhuroat parathënien për dy librat e tij me poezi. Dhe, varg për varg, me tekstin grek ngjitur, doje të kontrolloje se a janë përkthyer mirë. Takoheshim për këtë, e mban mend? Dhe pastaj filluam të shiheshim përsëri kur ai u lirua nga burgu dhe erdhi për të emigruar në Itali. Shkonim shpesh në darkë, të tre. Ngrënia me ty ishte gjithmonë një festë, sepse me ngrenë me ty kurrë nuk ishte e mërzitshme. Një mbrëmje, në atë restorantin që të pëlqente shkaku i mocarelave, erdhi edhe Ninetto. Të thërriste “baba”. Dhe ti e trajtoje ashtu si një baba që trajton djalin e tij, të lindur nga barku i tij dhe jo nga fara e tij. Të largoheshim nga ti pas darke, nga ana tjetër, ishte një mundim. Sepse ne e dinim se ku do të shkoje çdoherë. Dhe, çdoherë ishte sikur të shikonim të vrapoje drejt një takimi me vdekjen.

Çdoherë doja t’ju kapja për xhakete, t’ju mbaja, t’ju lutja, ta përsërisja atë që ju pata thënë në Nju-Jork: “Do të bësh që ta presin fytin, Pier Paolo!” Doja të bërtisja se nuk kishe të drejtë sepse jeta jote nuk të përkiste ty dhe mjaft, për etjen tënde, për shpëtim dhe mjaft. Letërnjoftimi në skelën Pier Paolo 32 na përkiste të gjithëve. Dhe na duhej. Askush tjetër në Itali nuk mund të zbulonte të vërtetën sikurse e zbulojë ti, të aftë të na bëjë të mendojmë se si na bënte të mendojmë, të na edukonte në ndërgjegjen civile siç na edukojë ti. Dhe unë të urreja kur largoheshe me atë makinën me të cilën të tre bandat kishin për ta shtypur zemrën. Të mallkoja. Por pastaj urrejtja shtynte në një admirim të çmendur dhe unë bërtisja: “Çfarë burri trim!” Nuk flas për guximin tënd moral tani, domethënë për atë që ju bëri të shkruani në këmbim të fyerjeve, keqkuptimeve, moskuptimeve, hakmarrjeve. Unë po flas për guximin tënd fizik. Duhet për të pasur mëlçi goxha të madhe për ta frekuentuar baltën që frekuentoje ti, natën. Mëlçi të krishterëve të fyer e tallur që hyjnë në Kolosseum për t’u shqyer nga luanët. Njëzet e katër orë para se t’ju shqyejnë, unë erdha në Romë me Panagulis. Erdha e vendosur të të shoh ty, të përgjigjem me gojë për atë që më kishe shkruar. Ishte një e premtë. Dhe Panagulis të telefonojë në shtëpi, por në shifrën e tretë u fut një zë që shënoi: “Vëmendje. Për shkak të sabotimit që ka ndodhur ditët e fundit në termocentralin Eur, shërbimi i numrave që fillojnë me 59 është pezulluar përkohësisht”. Të nesërmen ndodhi e njëjta gjë. Na erdhi keq sepse ne menduam që po vinim në darkë për ty të shtunën në mbrëmje, por e ngushëlluam veten duke menduar se mund të të shihnim të dielën në mëngjes. Për të dielën patëm një takim me Giancarlo Pajetta dhe Miriam Mafai në Sheshin Navona.

Morëm nga një pije dhe pastaj shkuam për të ngrënë. Ashtu rreth orës dhjetë të telefonuam përsëri. Por, përsëri u fut ai zëri që skanoi: vëmendje, për shkak të sabotimit numri nuk funksionon. Te sheshi Navona shkuam pa ty. Ishte një ditë e bukur, një ditë plot diell.

Në kafeterinë “Tre Scalini” filluam të flasim për Frankon (Françisko Franko, diktatorin spanjoll), i cili nuk vdes kurrë, dhe unë mendoja: do të më pëlqente të dëgjoja Pier Paolo të fliste për Frankon që nuk vdes kurrë. Pastaj na u afrua një i ri që shiste gazetën dhe i tha Pajettes: “E kanë vrarë Pasolinin”. E tha me një buzëqeshje, sikur duke njoftuar humbjen e një skuadre futbollit. Pajetta nuk e kuptoi. Apo nuk donte ta kuptonte? Ajo ngriti ballin egër e belbëzoj: “Kush? Kanë vrarë kënd?” E djali sërish tha: “Pasolinin”. Dhe unë, në mënyrë absurde: “Cilin Pasolin?” Djali: “Qysh cilin?! Qysh cilin Pasolin?! Pasolini, Pier Paolo”. Dhe Panagulis tha: “Nuk është e vërtetë”. Dhe Miriam Mafai tha: “Kjo është një shaka”. Por në të njëjtën kohë ajo u ngrit dhe vrapoi për të telefonuar e për të pyetur nëse ishte shaka. Ajo u kthye pothuajse menjëherë me një fytyrë të zbehtë. “E vërtetë. E kanë vrarë me të vërtetë”. Në mes të sheshit një shakaxhi me pantallona jeshile luante një tub të gjatë. Duke luajtur kërcente duke ngritur në mënyrë groteske këmbët e mbështjella me pantallonat jeshile e njerëzit qeshnin. “E vranë në Ostia, këtë nate”, shtoi Miriam. Dikush qeshi me zë të lartë sepse shakaxhiu tundi tubin e tij dhe këndoi një këngë absurde. Këndonte: “Dashuria ka vdekur, presje, dashuria ka vdekur, pikë! Prandaj unë ju qaj, presje, prandaj unë ju qaj, pikë!” Ne nuk shkuam për të ngrënë. Pajetta dhe Mafai u larguan me kokat ulur, unë dhe Panagulis filluam të ecim pa e ditur se ku.

Në një rrugë të shkretë ishte një bar i shkretë, me televizion ndezur. Hymë duke na ndjekur një riosh i cili pyeste i trembur: “A është e vërtetë? A është e vërtetë?” Dhe pronarja e barit pyet: “E vërtetë çka?” Dhe rioshi përgjigjet: “Për Pasolinin. Pasolini i vrarë”. Dhe pronarja e barit bërtet: “Pasolini Pier Paolo? Jezus! Jezus-Maria! I vrarë! Jezus! Duhet të jetë çështje politike!” Pastaj në ekranin e televizionit u shfaq Giuseppe Vannucchi (gazetar i lajmeve “Rai”) dhe dha lajmin zyrtar. Dy njerëz të rëndomtë që kishin zbuluar trupin tënd u shfaqën, gjithashtu. Ata thanë se nga distanca nuk dukeshë as si një trup, ishe shumë i masakruar. Dukeshe si një grumbull plehrash dhe vetëm pasi ata shikuan nga afër, vunë re se nuk ishin plehra, por se ishe një njeri. A do të më keqtrajtosh ende nëse them se nuk ishe një njeri, por ti ishe një dritë dhe një dritë është shuar?”

*Romë, 16 nëntor 1975
(Marrë nga numri i shtatë i revistës “Akademia”).
Përktheu: Leonora Buçinca)*

Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqinë e viteve 1912–1923

Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqi dhe fundi i Perandorisë Osmane, 1912–1923, i studiuesit amerikan Ryan Gingeras, përkthyer nga Virgjil Muçi, Botimet IDK

Flitet shumë për shqiptarët e Turqisë, por, në të vërtetë, për historinë e atyre dhjetëra mijëra syresh që emigruan në Anadoll mes viteve 1912-1923 dimë fare pak: Ç'ndodhi me ta pasi u vendosën në Anadoll? Pse autoritetet turke i shihnin me aq dyshim, duke mos i lejuar të vendoseshin në qytetet kryesore apo në zonat e konsideruara sensitive? Cila ishte qëndresa e tyre ndaj politikës së shpallur "për të shkukur me rrënjë gjuhën dhe zakonet e tyre", që të ktheheshin në qytetarë besnikë turq? Bazuar kryesisht në hulumtimet e kryera në arkivat turq, studiuesi amerikan Ryan Gingeras na sjell një vepër mjaft të rëndësishme për këtë pjesë thuajse të panjohur të historisë. "Narrativa nacionaliste e historisë së Shqipërisë shmang enkas një nënndarje të rëndësishme të popullsisë: ata që thjesht hoqën dorë krejtësisht prej nacionalizmit shqiptar. Ky segment i kombit "imagjinari" shqiptar përfaqësohej në mënyrë të veçantë nga një numër i madh individësh që emigruan jashtë viseve shqipfolëse të Ballkanit Jugor dhe shkuan u vendosën gjetiu". "Ndonëse në dukje nuk përbënin të njëjtin nivel kërcënimi vdekjeprurës për sigurinë e shtetit, si grekët dhe armenët, që në nenin e parë të talimname të vitit 1917 nënvizohet mosbesimi i përgjithshëm që ekzistonte ndaj shqiptarëve mbas krijimit të një shteti të pavarur shqiptar".

Ryan Gingeras, aktualisht profesor në Departamentin e Çështjeve të Sigurisë Kombëtare në Naval Postgraduate School, SHBA, konsiderohet një ndër njohësit më të mirë të historisë së Turqisë, Ballkanit dhe Lindjes së Mesme. Autor i katër librave, ku mund të përmendim "Rënia e Sulltanatit: Lufta e Madhe dhe fundi i Perandorisë Osmane" (2014) dhe "Heroina, krimi i organizuar dhe bërja e Turqisë moderne" (2015). Libri i tij "Brigje të pikëlluara" ka marrë çmimet "Rothschild Book Prize in Nationalism and Ethnic Studies" dhe "British-

Kuwait Friendship Society Book Prize". Më poshtë botojmë parathënien e autorit Gingeras:

Në qoftë se gjërat do të thuheshin troç, ky punim doli në dritë falë një akti b u r r a c a k ë r i e . Ambiciet e mia, të cilat shkonin përtej provimeve, ishin të prirura për kah njëfarë projekti radikal, sfidues. Pothuajse e kisha mbledhur mendjen që disertacionin do ta shkruaja rreth ndonjë cepi të Anadollit gjatë Luftës së Parë Botërore dhe/ose fillesave të Republikës Turke. Duke rrahur ta kap demin për brirësh, mora për nga Anadoli Lindor. Sakaq, m'u ndërmendën nja dy ide: ndoshta një studim se si qyteti i vogël i Naxçivan-it u bë pjesë e Azerbajxhanit; ca më mirë akoma, rindërtimi i Kars-it si rrjedhojë e krijimit të Republikës Turke. Të dyja tok, thashë me vete, hyjnë në punë që ç'ke me të. Por ja që miq e kolegë me një barrë përvojë në studimet osmane më paralajmëruan e më thanë se, në thelb, nuk po bëja gjë tjetër veçse do t'ia hiqja vetes profesionalisht. Pikësëpari, ishte çështja e burimeve. Ku do t'i gjeja? A ekzistojnë vallë asi dokumentesh? Dhe çka ishte më e rëndësishmja, a do të më lejonin arkivistët turq të shihja dokumentet (një pyetje kjo që pasohet nga histori anekdotike tmerresh rreth studiuesve që u mohohet hyrja në arkivat shtetërore në Turqi)?

Paskëtajin vinin pasojat politike që duheshin pasur parasysh. Një disertacion që kishte të bënte me kurdët, armenët dhe subjekte të tjera që konsideroheshin tabu në Turqi, veçse do të më hapte telashe. Pavarësisht se çfarë

kisha për të nxjerrë nga duart, më thanë, dikujt kishte për t'i mbetur hatri prej punës sime. Dikush tjetër, qoftë ai ndonjë ministër turk, pjesëtar i diasporës armene ose ndonjë studiues osman, kishte për të më ngrënë me gjithë lecka, duke qenë se kisha sfiduar, mbështetur ose shpërfillur një sërë aspektesh të historisë së kohëve të fundit të Anadollit Lindor. Me pak fjalë, këshilla që më dhanë ishte kjo: mos e bëj. Mos e vrit karrierën tënde, pa filluar mirë. Përfundimisht, disertacioni që shkrova u ngrit mbi këtë këshillë. Koha e kaluar

e qark. Mjaft të zija ngoje dhe të shprehja interesin tim lidhur me emigrantët myslimanë në Anadoll dhe kjo gjë përshëndetej me një entuziazëm të çiltër e gjente mbështetje sakaq nga arkivistët, të cilët ndihmuan që hulumtimi im të bëhej i mundur. Sidoqoftë, rrallëherë e preka temën e armenëve dhe të grekëve me punonjësit e arkivave. Duke qenë se nuk përbënte diçka qendrore ku qe fokusuar punimi im, fati paralel i jomyslimanëve në Anadollin Perëndimor gjatë viteve të luftës përbënte një subjekt që e mbaja të fshehtë. Këshillat e dikurshme gjëllinin ende në mendjen time. Kjo parathënie shërben si një apologji dhe shpjegim i tërthortë për vijueshmëritë dhe mosvijueshmëritë që vihen re midis disertacionit dhe këtij libri. Pyetja se çfarë ndodhi me grekët dhe armenët e Anadollit (por edhe me grupet e tjera të kriminalizuara) përgjatë viteve 1912-1923, vijon të peshojë edhe sot e kësaj dite si një gorillë 500-paundëshe mbyllur në një dhomë. Ngjarjet e kohëve të fundit, siç qe vrasja e Hrant Dinkut, e vërtetojnë këtë gjë. Prapëseprapë, unë jam i mendimit se persekutimit të të krishterëve osmanë nuk mund t'i qasemi

të izoluar. Për më tepër, rreth kësaj pike për mua është krejt e qartë se, përgjatë gjithë kësaj kohe, ka një histori më universale për të kallëzuar lidhur me nivelin dhe domethënien e vuajtjeve njerëzore në Anadoll. Siç do të qartësohet në faqet më vijim, modele të ngjashme të të arsyetuarit dhe të të sjellurit nga ana e qeverisë osmane, por edhe nga fuqitë pushtuese të Greqisë e vendeve të tjera, shpunë në zhvendosjen në masë, shfarosjen si të të krishterëve ashtu edhe të myslimanëve. Shkalla në të cilën bashkësi të ndryshme u viktimizuan nga trupat shtetërore që haheshin me njëra-tjetrën, doemos që ndryshon në mënyrë të papërfytyrueshme (në qoftë se do të shtrëngoheshin të bëja një krahasim, atëherë është më se e qartë se, aty nga viti 1923, armenët dhe grekët së toku zinin

një pozitë shumë herë më pak të lakmueshme sesa emigrantët myslimanë). Në qoftë se dikush merr të krahasojë nivelin e vuajtjeve, kjo nuk ka të bëjë me punën tonë. Përkundrazi, ky libër shtron pyetjen dhe merret saktësisht me faktin se përse, vallë, dhe në ç'masë grupe të mëdha njerëzish që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara iu nënshtruan një sërë fushatash që synonin t'u bënin keq. Për të ndriçuar më mirë unanimitetin e vuajtjeve të zbuluara në gjirin e bashkësive të ndryshme që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara, e vura theksin kryesisht mbi çështjen armene dhe atë greke. Edhe pse nuk kam kurrfarë dyshimi për këtë gjë, unë besoj se këta hapa vijnë në ndihmë për të ngushtuar hendekun historik midis të krishterëve vendas dhe myslimanëve të ardhur, madje shumë më mirë se orvatja ime e mëparshme. Ndonëse teksti që vijon nuk është këqyrrur si një punim krahasues, mund të thuhet se historia e Anadollit përgjatë kësaj periudhe kohore nuk është diçka unike në kuptimin global. Diskriminimi në masë dhe likuidimi i popullsisë vendase është një fenomen që mund ta pikasësh kudo nëpër botë. Terrori shtetëror i kësaj natyre është një dukuri moderne dhe si e tillë, është pjesë përbërëse e logjikës moderne të shtetndërtimit. Duke e vendosur këtë studim brendapërbrenda një rajoni të caktuar, si dhe duke iu qasur një mase të qartë e të përcaktuar njerëzish, unë shkoj e ndërmarr disa koncepte të ngjeshura, historike dhe, siç pranohej përgjithësisht, tejet kritike: modernizimi i shtetit, dhuna e organizuar, formimi i identitetit, emigracioni dhe rrjetet e politikës. Duke e kufizuar punimin tim, si nga ana gjeografike ashtu edhe sociale, shpresoja që ta bëja më të manovrueshëm diskutimin e gjithë këtyre fijeve të larmishme historike, ndërsa narrativën sa më të padukshme. Duke hedhur sytë pas mund të them se nuk më vjen keq që shkova dhe ndoqa këshillat e kolegëve të mi të besuar. Tek e fundit, unë e ndiej se më kanë shpënë pas për të shtjelluar objektivat e mi zanafillorë. Gjithsesi, shpresoj se të tjerë njerëz (që e kanë lëkurën më të trashë se timen) kanë për t'u marrë me historitë e Kars-ës dhe të Naxçivan-it, si dhe ngjarje të tjera me peshë për t'u kallëzuar.



Operacioni ushtarak që frymëzoi filmin ‘1917’!?



A është filmi “1917”, i bazuar mbi një histori të vërtetë? Po edhe jo. Filmi dramatik me ngjarje nga Lufta e Parë Botërore, me skenar dhe regji të Sem Mendes, tregon historinë e dy ushtarëve të rinj britanikë të cilët urdhërohen nga komanda të kalojnë në “tokën e askujt” (hapësirën mes dy llogoreve armike), që të parandalojnë një sulm të planifikuar britanik, i cili kishte të ngjarë të sillte vdekjen e qindra ushtarëve. Këta dy ushtarë nuk kanë ekzistuar vërtet, madje asnjë nga ata për të cilët flitet në film. Por, teksa personazhet në film janë imagjinarë, ngjarjet e vitit 1917 u bazuan mbi një tërheqje të vërtetë strategjike që ndodhi në fakt nga ushtria gjermane, koduar me emrin “Operacioni Alberich”.

Idea për filmin “1917”, regjisorit të njohur i erdhi nga gjyshi i tij Alfred Mendes, që ishte një lajmëtar për britanikët në Frontin Perëndimor. Mendes dëshironte të nderonte kujtimin e gjyshit e të tij, por edhe të të gjithë trupave që luftuan në Luftën e Parë Botërore.

“Unë kisha një histori familjare, që ishte një fragment i treguar nga gjyshi im. Është historia e një korrieri që ka një mesazh për ta dërguar dikë. Ajo histori më intrigoj shumë që kur isha fëmijë. Padyshim, unë e kam zgjeruar dhe ndryshuar shumë atë. Gjithsesi, ajo e ka

ende thelbin e saj”, deklaroi Mendes në një intervistë për “Time”.

Mendes dëshironte që filmi të bazohej mbi ngjarjet e vërteta të Luftës së Parë Botërore, dhe të ishte sa më i saktë në aspektin historik. Kur ishte duke hulumtuar mbi skenarin e filmit, Mendes gjeti një ambient perfekt: Operacionin Alberich. Deri në vitin 1917, Fronti Perëndimor ishte shndërruar në një luftë të egër llogoresh dhe forcat gjermane mezi po rezistonin. Ato kishin kaluar nga ofensiva në mbrojtje, përballë presionit të pamëshirshëm nga trupat bri-

tanike dhe franceze, me Betejën e Verdunit dhe Betejën e Somës që dobësuan shumë gjermanët.

Erich Ludendorff, që ishte bërë kohët e fundit një nga figurat kryesore të rezistencës gjermane, bëri në fundin e vitit 1916 një panoramë të zymtë të shanseve të Gjermanisë për fitoren e luftës. Në atë kohë ai shkruante: “Gjermania duhet të mos harrojë se epërsia e madhe e armikut në njerëz dhe materiale, do të ndjehej edhe më dhimbshëm në vitin 1917. Nëse lufta do të zgjaste, humbja jonë dukej e pashmangshme. Ekonomikisht, jemi në një pozitë shumë të pafavorshme për një luftë të gjatë”.

Duke e ditur se gjermanët kishin nevojë për një strategji të re që të shmangnin humbjen e luftës, Ludendorff prezantoi Operacionin Alberich. Bëhej fjalë për një tërheqje të guximshme dhe strategjike, që do t'i lejonte trupat gjermane të riorganizoheshin dhe të krijonin një linjë mbrojtëse më të shkurtër dhe më të fortifikuar, të quajtur “Linja Hindenberg”. Dhe kjo, në një kohë kur forcat aleate do të supozonin se armiku i tyre po braktiste betejën. Në këtë mënyrë, trupat britanike do të binin pa vetëdije në një kurth, nga pozicioni i fortifikuar i krijuar nga “Alberich”. Tërheqja nisi zyrtarisht më 9 shkurt dhe përfundoi më 20 mars, duke e shkurtuar me 40 kilometra frontin gjerman dhe duke u dhënë mundësi ta mbronin atë me më pak se 14 divizione.

Por, tërheqja ishte vetëm një pjesë e operacionit. Që të siguroheshin që trupat britanike të

mos kishin qasje në burimet e lëna pas, gjermanët përdorën politikën e “tokës së djegur”. Pra, shkatërrimin e çdo gjëje që mund të rezultonte e dobishme për forcat aleate, përfshirë qytetet, rrugët dhe urat. Ndërkohë, gjermanët minuan shumë zona që britanikët të vonoheshin sa më shumë në pushtimin e zonës së braktisur tashmë nga forcat gjermane.

Operacioni “Alberich” u zbatua me sukses. Gjermanët ia dolën të zhvendosnin vijën e tyre mbrojtëse, ndërsa britanikët besuan se armiku i tyre ishte në një tërheqje të plotë. Pra, britanikët do të supozonin se po sulmonin një linjë mbrojtëse gjermane të dobësuar, por në fakt do të zbulonin se ajo ishte e riorganizuar dhe plotësisht gati për të ndërmarrë një kundërsulm.

Ky është konteksti mbi të cilin fillon filmi “1917”, kur dy ushtarët dërgohen në një mision për të paralajmëruar trupat britanike, para se të bien në kurthin e linjës mbrojtëse të sapokrijuar. Meqë britanikët besuan fillimisht se gjermanët po tërhiqeshin të dëshpëruar, ata supozuan se një sulm kundër tyre në atë moment do t'i jepte një avantazh të mëtejshëm në luftë dhe potencialisht do të çonte në një fund të shpejtë të konfliktit. Përkundrazi, ata zbuluan se gjermanët kishin krijuar një linjë të re mbrojtëse prej 128 kilometrash, e cila ishte shumë më e fortë sesa sistemi i tyre i mëparshëm mbrojtës.

Edhe pse ishte më e shkurtër, Linja Hindenburg u dha forcave gjermane disa avantazhe

strategjike të mëdha, përfshirë një terren më të lartë, gjë që ua vështirësonte trupave britanike përparimin gjatë sulmeve. Kjo vonoi ndjeshëm planet britanike në pranverën e atij viti, pasi strategjia e tyre sulmuese u ngadalësua.

Në filmin “1917”, ushtari William “Will” Schofield, arriti të njoftojë në kohë kolonelin Mackenzie që të anulonte sulmin britanik, që ishte në nisje e sipër. Në realitet, aleatët u kapën më së shumti në befasi dhe Linja e Hindenburgut e ndali vrullin e tyre. Për pasojë, rifilloi lufta e egër e llogoreve, duke zhdukur për momentin çdo shpresë për fundin e shpejtë të luftës.

Gjithsesi, Operacioni “Alberich” vërtetoi se mund të ndalte vetëm përkohësisht të pashmangshmen. Forcat aleate arritën ta çanin atë më 29 shtator 1918, falë një bombardimi masiv që zgjati mbi 50 orë, përdorimit të batalioneve të tankeve dhe një numri të madh ushtarësh amerikanë. Në atë kohë, Linja Hindenberg ishte linja e fundit mbrojtëse për gjermanët, ndaj shkatërrimi i saj e rrënoi moralin e ushtrisë gjermane.

Më 11 nëntor 1918, një armëpushim i dha fund Luftës së Parë Botërore. Mund të mos jetë e drejtë të kritikohet një komb në luftë, pse bën gjithçka që mundet për ta fituar atë. Por, po të mos ishte për suksesin e Operacionit “Alberich”, ndoshta lufta do të kishte përfunduar shumë më shpejt, dhe mijëra burra nuk do të kishin vdekur.

/Burimi: All That is Interesting/Në shqip nga: Bota.al/

E rrallë

Ishulli i Palmas në Dubai shpallet mrekullia e tetë e botës

Palma "Jumeirah" shpallet edhe mrekullia e tetë e botës, simbol ky i krijimtarisë. Sipas mediave të huaja, ky ishull artificial në formë palme në Dubai u ndërtua me mbushjen e rërës dhe gurëve. Gjysmëhëna prej 11 kilometrash e "veshur" me hotele me pesë yje, është ajo që e simbolizon më së shumti arkitekturën e saj, bashkë me një aureolë mbrojtëse që përmban dy anë të hapura që lejojnë ujërat e kaltër të rrjedhin brenda saj.



FOTO E DITES



Indianët luajnë me pluhur me ngjyrë në një festë tradicionale në Jammu. /AP/

E jashtëzakonshme

Macja e rrugës me shenjë mini-mace në fytyrë bëhet virale në rrjetet sociale

Një kotele e adhureshme, por e veçantë prej një forme të vogël maceje në hundën e saj, është hiti i momentit në mediat sociale pasi një përdorues e pikasi atë anës një rruge. Në pamje të parë kotelja bardhë e zi duket si çdo mace tjetër, por nëse vështrohet nga afër në fytyrën e saj, duket një tjetër mace e vogël në një motiv të rrallë që ka magjepsur përdoruesit e rrjetit. Disa komentues e krahasojnë atë me Hitlerin, prej mustaqes së veçantë.

**DASHI**

T'i bëni gjërat me forcë nuk do t'ju bëjë që t'i realizoni qëllimet tuaja. Ju nuk mund t'i shtyni njerëzit të jenë atje ku dëshironi që ata të jenë.

**DEMI**

Ju dhe një mik po afroheni më afër dhe duket se secili prej jush është tifozi më i madh i tjetrit.

**BINJAKËT**

Sot duhet ta kuptoni ndryshimin midis një beteje nga e cila mund të fitoni dhe një luftë nga e cila thjesht duhet të largoheni.

**GAFORRJA**

Ide të çuditshme do të vijin sot në kokën tuaj majtas dhe djathtas dhe sa më të çmendura të jenë, aq më mirë!

**LUANI**

Partneri juaj mendon se ai ose ajo di më së miri për një projekt të caktuar sot, por ju e dini më mirë ose të paktën ju mendoni se e dini.

**VIRGJËRESHA**

Sot ndjenjat do t'ju pengojnë në rrugën tuaj duke ju larguar nga realizimi i asaj që duhet të bëni.

**PESHORJA**

Jeta juaj ka qenë e qetë kohët e fundit, por rezulton se nuk është saktësisht ajo që keni dashur, në fund të fundit.

**AKREPI**

Mos lejoni që arroganca e dikujt tjetër të futet nën lëkurën tuaj sot sepse nuk do t'ju ndihmojë për asgjë.

**SHIGJETARI**

Jeni një perfeksionist i pan-dreqshëm! Ju mund të identifikoheni duke qenë të pakënaqur në veten tuaj.

**BRICJAPI**

A po ndiheni shumë i kufizuar nga një marrëdhënie? A mendoni se po mbyteni nga ky person?

**UJORI**

Si mund të largoheni nga gabimet e së kaluarës kur nuk doni që t'i harroni ato? Ju jeni një person i mrekullueshëm.

**PESHQIT**

Energjia juaj do të lulëzojë më së miri në një mjedis më të qetë, ku ju jeni vetëm ose shoqëroheni vetëm nga një ose dy persona të tjerë.

BARSOLETA E DITËS



Në vitin e parë të martesës flet burri e dëgjon gruaja.
Në të dytin gruaja flet e burri dëgjon.
Në të tretin flasin të dy e dëgjojnë komshinjtë.



Programi i shfaqjes së filmave
në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info**, **www.kinoabc.info**, **fb: Kino ABC**.

Pas thashethemeve se kaloi natën me Joey Essex, Rita Ora fsheh sytë e saj me size



Ajo shijoi një festë 24-orëshe me nënshoqërinë e Joey Essex dhe një mori të famshëm të tjerë nga e enjtja deri të premtën që lamë pas. Rita Ora, 29-vjeçare, ende po fshihte sytë pas një palë syzeve të diellit

të mëdha të dielën, ndërsa shijonte një shëtitje të kohës së lirë me miqtë. Ajo ishte e mbështjellë kundër të ftohtit, veshur me një xhaketë të verdhë dhe një kapele bejsbolli në kokë, shkruan "DailyMail".

Madonna anulon shfaqjet e fundit të "Madame X" në Francë për shkak të koronavirusit



Ylli botëror, Madonna, i ka dhënë fund turneut të saj "Madame X Tour" për shkak të koronavirusit. Këngëtarja njoftoi të hënën se dy koncertet e saj të mbetura, të planifikuara për 10

dhe 11 mars në Paris, Francë janë anuluar. Kjo vjen pasi autoritetet franceze ndaluan mbledhjet e më shumë se 1 000 personave si pjesë e përgjigjes së tyre ndaj përhapjes së koronavirusit.



Vanessa Bryant fotografohet krah vajzave pranë muralit të Kobes dhe Giannas

Vanessa Bryant ka postuar një fotografi në rrjetin social "Twitter" bashkë me vajzat e saj këtë javë, duke qëndruar pranë një murali të bashkëshortit të saj të ndjerë, Kobe Bryant dhe vajzës Gianna. Legjenda e 'Lakers'-it dhe vajza e tij 13-vjeçare, Gianna, me

shtatë persona të tjerë ndërruan jetë në janar të këtij viti në një përplasje helikopteri në malet e Calabasas, Kaliforni. E veja e Kobes ka publikuar një fotografi me tekstin e këngës "Smile", këngë kjo e realizuar dhe e bërë e famshme nga Nat King Cole.

Chris Rock ndahet nga e dashura pas katër vjetësh lidhje

Chris Rock është ndarë nga e dashura e tij, aktoria Megalyn Echikunwoke, pas katër vjetësh lidhje dashurie. Disa burime e kanë konfirmuar për "Page Six" se 55-vjeçari Rock dhe 36-vjeçarja Echikunwoke janë ndarë pa shumë zhurmë disa muaj më parë, para se ai të ishte në qendër të vëmendjes në Oscars me shakatë lidhur me divorcin e miliardarit dhe pronarit të Amazon Jeff Bezos. Një burim ka thënë se Rock nuk ishte gati që kjo lidhje të përfundonte me martesë pas divorcit të dhimbshëm me gruan Malaak Compton-Rock, pas 18 vjetësh martesë.





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Komiteti Ekzekutiv i jep mbështetje kryetarit Ademi

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së i ka dhënë mbështetje kryetarit Agim Ademi i cili është dënuar me 9 muaj burgim efektiv. Ademi është zotuar se do t'i ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe gjithmonë do të jetë në koordinim me KE, FIFA-n dhe UEFA-n

"Epoka e re"

PRISHTINË, 10 MARS - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) mbajti mbledhjen e vet të radhës, nën drejtimin e kryetarit Agim Ademi, ku diskutoi për shumë çështje me rëndësi për futbollin e Kosovës. KE analizoi edhe çështjen e dënimit të presidentit Agim Ademi nga ana e Gjykatës së

Apelit, duke konsideruar se dënimi i tij është i padrejtë. "KE me unanimitet të plotë i dha përkrahje kryetarit që të vazhdojë t'i ndjekë rrugët ligjore të lejueshme për ta zbardhur rastin deri në instancën e fundit - Gjykatën Supreme. Ndërsa kryetari Ademi e falënderoi për përkrahjen e vazhdueshme KE-në dhe deklaroi se do ta ndjekë rrugën ligjore të lejuar deri në verdiktin e fundit dhe çfarëdo

qoftë ai, do t'i bindet dhe do të jetë në koordinim me KE-n, UEFA-n e FIFA-n dhe delegatët përkrahës, si dhe do t'i njoftojë për të gjithë hapat e mëtejshëm", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

KE i FFK-së, po ashtu, analizoi rrjedhën e garave në IPKO Superligë dhe rangjet e tjera duke konstatuar se deri më tani garat po rrjedhin mirë e me dinamikën e paraparë me disa raste të



kontestuar, edhe për faktin se kampionati po hynë në fazën finale, prandaj KE u kërkon komisioneve të FFK-së që të punojnë me seriozitet dhe

profesionalizëm dhe t'i marrin masat e duhura ndëshkimore pa përjashtim, sikur që KE do t'u dalë në mbrojtje të gjithë atyre që sulmohen pa të drejtë.

Nënshkruhen kontratat me 10 bursistët 'Shpresa Olimpikë 2020'

PRISHTINË, 10 MARS - Komiteti Olimpik i Kosovës ka nënshkruar kontratat me 10 bursistët të cilët do të marrin paga mujore nga KOK-u si "Shpresa Olimpikë 2020". Në ceremoninë e organizuar në "Hotel Sirius" në Prishtinë, krahas drejtuesve të KOK-it, presidentit Besim Hasani dhe sekretarit të përgjithshëm Shasivar Haxhijaj, morën pjesë sportistët, trajnerët dhe përfaqësuesit e federatave. Sportistët që do të marrin paga nga 100 euro në muaj gjatë vitit 2020 janë: Arti Krasniqi (not), Fatjona Kasapi (xhudo), Betim Maliqi (karate), Albina Deliu (atletikë), Besart Pireva (boks), Alaudin Suma (atletikë), Edi Dvorani (shigjetari), Njomza Nuraj (taekwondo), Vesa



Gjinaj (tenis) dhe Fatlum Brakaj (mundje).

Presidenti Hasani ka thënë se KOK-u do të jetë në mbështetje të realizimit të ëndrrave të sportistëve. "Padyshim se në një konkurrencë të jashtëzakonshme,

ju 10 sportistët keni qenë më të mirë se të tjerët për disa nuanca, por nuancat e bëjnë dallimin dhe me këtë kemi dashur ta dëshmojmë se sportistët jo që janë në zemër të KOK-it, por janë vetë zemra e KOK-it. Ne presim nga ju

që ky të jetë një motiv për t'u angazhuar shumë më tepër, për të arritur më shumë dhe të ecni sigurt drejt realizimit të ëndrrave tuaja", ka thënë Hasani.

Sekretari i përgjithshëm, Haxhijaj, ka deklaruar se KOK-u ka rritur numrin e bursistëve nga gjashtë në dhjetë, derisa përmendi edhe bursat Olimpikë Tokio 2020 dhe LOD Pekini 2022, të cilat jepen në bashkëpunim me Solidaritetin Olimpik të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. Në emër të sportistëve, taekwondistja Njomza Nuraj tha se kjo përkrahje është lehtësim sado i vogël për ta vazhduar karrierën dhe se tani e tutje nuk do të mendojmë për problemet financiare, por vetëm

për rezultate. Edhe boksieri Besart Pireva u shpreh se atyre u mbetet t'ua shpagojnë besimin KOK-it dhe mënyra më e mirë për këtë është kualifikimi në LO Tokio 2020. Pikërisht Pireva do ta synojë normën Olimpikë 2020. Krahas këtyre 10 Shpresave, BE i KOK-it në fund të vitit 2019 përzgjedhi edhe 10 Shpresa Olimpikë 2020 të cilat do të marrin paga mujore në vlerë 150 euro nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport. Pas ceremonisë, u organizua edhe një ligjëratë për njohuri të anti-dopingut, ku sportistëve dhe trajnerëve iu ligjëroi koordinatori i KOK-it për anti-doping në Kosovë, Gëzim Murseli, njëherësh anëtar i Komisionit Mjekësor të KOK-it.

FShF-ja: Futbolli nuk ndërpritet, por zhvillohet me dyer të mbyllura

TIRANË, 10 MARS - Koronavirusi ka mbërritur edhe në Shqipëri. Deri tani janë regjistruar 6 persona të prekur dhe kjo ka bërë që paniku të jetë i madh. Të hënën kryeministri Edi Rama deklaroi se të gjitha aktivitetet ku mblidhen njerëz do të pezullohen, duke përfshirë edhe ato sportive. Ndërsa të martën

Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) ka dalë me një komunikim zyrtar, ku thuhet se të gjitha ndeshjet do të luhen sipas programit, por me dyer të mbyllura. "Komiteti i Emergjencës në Federatën Shqiptare të Futbollit, pas mbledhjes së jashtëzakonshme dhe



komunikimeve zyrtare me Këshillin e Ministrave, ka vendosur

t'i njoftojë klubet se aktiviteti futbolistik në Shqipëri do të vijojë sipas kalendarit zyrtar të parashikuar nga Sektori i Garave, por ndeshjet do të zhvillohen me dyer të mbyllura. Kjo masë është marrë pas vendimit të djeshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në respekt

të ruajtjes së shëndetit publik të sportdashëve dhe të gjithë personave të përfshirë në garën futbolistike në vend. Federata Shqiptare kërkon mirëkuptimin e të gjithë palëve si një vlerësim objektiv për situatën në të cilën ndodhet vendi", thuhet në njoftimin e FShF-së.

Zyrtare: Maqedoni - Kosovë zhvillohet pa shikues

SHKUP, 10 MARS - Konfirmohet vendimi nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut për ndeshjen e radhës kundër Kosovës. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë

mbledhjes së sotme ka pranuar rekomandimet e komisionit për sëmundje ngjitëse. Krahas mbyllës së shkollave, qeveria vendosi që të gjitha ndeshjet sportive të luhen pa

praninë e publikut për 30 ditët e ardhshme. Sipas këtij vendimi, ndeshja e shumëpritur Maqedoni - Kosovë, e paraparë për më 26 mars, do të zhvillohet pa praninë e pub-

likut. "Ndalohet mbajtja e ndeshjeve sportive me publik në 30 ditët e ardhshme në territorin e gjithë shtetit", deklaroi Venko Filipçe, ministër i Shëndetësisë.



Peja merr organizimin e ‘Final Four’-it në Ligën Ballkanike

PEJË, 10 MARS - KB Peja e ka marrë përsipër organizimin e ‘Final Four’-it në Ligën Ballkanike. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e klubit.

bit pejan. “Ju njoftojmë se presidenti i klubit, Art Gashi, ka marrë përsipër që ne të jemi organizatori i ‘Final Four’ të Ligës Ballkanike. Palestra

më e zjarrtë e sezonit, qyteti i basketbollit, foleja e Shqiponjave, do të ketë pamje tjetër më 31 mars dhe 1 prill”, thuhet në njoftimin e KB Peja.

Skuadrat pjesëmarrëse në “Final Four” janë: KB Peja, KS Vllaznia, BC Academic Bultex, Plovdiv BG, KK Ibar dhe Rozhajë MNE.



Liverpooli dhe PSG-ja synojnë përmbysjen e rezultatit ndaj Atletico dhe Dortmundit

LIVERPOOL, 10 MARS - Kampioni në fuqi i Evropës, Liverpool, e humbi ndeshjen e parë të 1/8 së finale në Ligën e Kampioneve kundër Atletico Madridit (1-0), por sonte shpreson që ta përmbysë këtë rezultat dhe të kualifikohet në çerekfinale. Trajneri Jurgen Klopp e pranon se Liverpooli nuk do ta ketë aspak lehtë të kualifikohet në fazën tjetër, por shpreson se me ndihmën e tifozëve do të arrihet synimi. “Do të jetë ndeshje ku duhet të tregojmë se çfarë kemi mësuar nga dueli i parë në Madrid dhe të dëshmojmë se vërtet duam të kalojmë tutje. Ka shumë mundësi për ne, por kundër një skuadre kualitative do të jetë e vështirë t’i gjejmë ato. Tifozët i kemi dhe duhet të tregojmë një paraqitje të jashtëzakonshme në fushë në të gjitha repartet, nëse duam të arrijmë çerekfinalen”, ka thënë Klopp. Lajm i mirë për skuadrën angleze është rikthimi i kapitenit Jordan Henderson, i cili ka munguar në katër ndeshjet e fundit. Gjithashtu, për këtë ndeshje i gatshëm është edhe mbrojtësi



anësor Andrew Robertson. Ndërkohë, mungesa, përveç Alisson Becker, janë edhe shqiptari Xherdan Shaqiri dhe Nathaniel Clyne. E në skuadrën e Diego Simones, i vetmi që mund të mos jetë i gatshëm është mbrojtësi Kieran Trippier. Sikurse Liverpooli, edhe Paris Saint-Germain synon ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë në “Parc des Princes” ndaj Borussia Dortmundit (2-1). Klubi francez ka një përparësi të vogël, pasi ka shënuar një gol në ndeshjen si mysafir dhe ai mund të jetë vendimtar për t’u kualifikuar tutje. Ndërsa

mungesë e madhe do të jenë shikuesit për PSG-në, pasi është raportuar se kjo ndeshje do të luhet me dyer të mbyllura për shkak të frikës së përhapjes së koronavirusit. Marco Verratti dhe Thomas Meunier mungojnë në këtë ndeshje për shkak të kartonëve, kurse në dyshim janë kapiteni Thiago Silva dhe Colin Dagba. Gjermanët në këtë ndeshje do të jenë pa të lënduarit Marco Reus dhe Thomas Delaney.

TË MËRKURËN TAKOHEN:		
Liverpool - Atletico Madrid	(0-1)	
PSG - Borussia Dortmund	(1-2)	

Tjetër disfatë për skuadrën e Milwaukeees, Toronto siguron ‘play-off’-in

MILWAUKEE, 10 MARS - Humbja e dytë radhazi për skuadrën e Milwaukeees, që u mund me rezultat 109-95 nga Denveri, sfida e dytë radhazi ku skuadra e Bucksit luan pa MVP-në, Giannis Antetokounmpo. Korver me 23 pikë ishte shënuesi më i mirë për Milwaukeeen që, pavarësisht humbjes, qëndron në krye të renditjes në Lindje. Për Denverin u dalluan Murray me 21 pikë e Millsapi me 20 pikë e 10 rebounde. Fitore ka regjistruar edhe skuadra kampione e Torontos, që mposhti me rezultat 101-92 Utah Jazzin, një përballje mes dy ekipesh pretendente në konferencat përkatëse. Herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Siakam me 27 pikë e 11 rebounde si dhe Ibaka me 27 pikë e 13 rebounde ishin dy shënuesit më të mirë për Toronto, ndërsa për Jazz mungoi



lojtari lider. Pas kohës shtesë fitore arriti skuadra e Atlantës, e cila e mundi me shifrat 143-138 Charlotten, ndeshje që u vendos pas 10 minutave shtesë. Një ndeshje fantastike, ku për

Atlanta u dalluan Young me 31 pikë e 16 asistime si dhe Collins me 28 pikë e 11 rebounde. Për Charlotten, Rozier realizoi 40 pikë, por që mbetën për statistikë.

SHKURT

Shtyhet turneu për gjenerata të reja, shkak frika nga koronavirusi

Nga 13 deri më 16 mars në Prishtinë ishte paraparë të organizohet turneu në basketboll për Zhvillimin e Gjeneratave të Reja (YDF) të FIBA Evropës. Por, ky turne është shtyrë për shkak të frikës nga koronavirusi që është paraqitur në shumë shtete evropiane, duke përfshirë edhe fqinjët e Kosovës, Shqipërinë, Maqedoninë Veriore dhe Serbinë. Në këtë turne pjesëmarrjen, përveç ekipeve të Kosovës, e kishin konfirmuar edhe Maqedonia Veriore, Turqia, Rumania dhe Bullgaria, me dy ekipe, një në konkurrencën e meshkujve dhe një në atë të femrave për kategorinë U15. Por, turneu është shtyrë me kërkesën e shteteve pjesëmarrëse dhe me pajtim të FIBA Evropës.

La Liga dy javë pa tifozë

Federata Spanjolle e Futbollit ka zyrtarizuar se dy javët e ardhshme të La Ligas do të luhen pa praninë e tifozëve si masë paraprake për t’u ruajtur nga përhapja e koronavirusit. Ndeshjet me dyer të mbyllura do të nisin të premten e 13 marsit me sfidën Real Madrid-Eibar. Ndërkohë ka hyrë që tani në histori pa luajtur ende derbi mes Sevillass dhe Betisit që për herë të parë në historinë e futbollit spanjoll do të luhet pa tifozë.

Walter: Goretzka më ngjason me Ballackun


Ish-trajneri i Shtutgartit, Tim Walter, e krahason mesfushorin e Bayern Munchenit, Leon Goretzka, me një nga ikonat e futbollit gjerman, Michael Ballack. “Më ngjason shumë me Michael Ballackun. Mënyra se si shënon dhe pozicionohet në fushë. Sigurisht se nuk ka ende atë prekje të topit siç e kishte Michael. Është lojtari i duhur për skuadrën e Bayernit, një mesfushor i kompletuar që jo vetëm ndërton lojën, por edhe shënon”, ka thënë Walter.

Drejtori i Ferrarit: Nuk kemi asnjë shans ta fitojmë garën e Australisë

Ferrari ka mbërritur në Australi, ku ditën e diel do të zhvillohet gara e parë sezonale në Formula 1. Mattia Binotto, drejtori sportiv i “kokëkuqes”, është pesimist për këtë debutim sezonal. Ai shprehet se Ferrari nuk është aq i shpejtë sa të fitojë në pistën e Melburnit: “Nuk besoj se do të jemi në gjendje të fitojmë në Australi”. “Natyrisht se çdo makinë ka problemet e saj, disa të rikuperueshme, disa jo. Disa kanë të bëjnë me besueshmërinë, disa me gomat, disa shpejtësinë etj. Ndaj, në një garë gjithçka mund të ndodhë”, u shpreh Binotto. “Gjithsesi, nuk jemi aq të shpejtë për të dueluar për fitoren. Nuk fshihemi pas gishtit, ky është realiteti. Vetëm pas tri garave të para do të bëjmë një analizë të gjendjes”, ka shtuar Binotto.

Augsburgu shkarkon trajnerin

Martin Schmidt nuk do të jetë më trajneri i skuadrës së Augsburgut. Skuadra gjermane nuk e ka kapërdirë mirë humbjen në “Allianz Arena” ndaj Bayernit dhe ka vendosur ta ndërpresë bashkëpunimin me Schmidtin. Ky i fundit deklaroi, pas ndeshjes me kampionët, se skuadra e tij ishte e pafuqishme ndaj një kundërshtari si Bayerni. “Nuk mund të bësh më shumë këtu në Munchen ndaj një skuadre të tillë. Djemtë dhanë gjithçka në fushën e lojës, por kaq është mundësia jonë”, kishte deklaruar Shmidi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

KOMUNA SKENDERAJ

Komisioni vlerësues i ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës. (Vendim të Kuvendit të Komunës së Skenderajt Nr. 01-463/01-0076422/19, dt. 31/12/2019, Konfirmimi I ligjshmërisë së MAPL-së Nr. 020-7/1, i dt. 20.01.2020, mbështetur në vendimin Nr. 01-463/01-0076423/19 i dt.31.12.219, Konfirmimi I ligjshmërisë së MAPL-së Nr. 020-7/2, i dt. 20.01.2020 për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim afatshkurtër prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 27.02.2020 mori këtë:

VENDIM

Në bazë të legjisllacionit në fuqi, përkatësisht të nenit 5 pika b, nenit 13, nenit 14 pika 14.2, nenit 17 të ligjit Nr. 03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale, si dhe të nenit 50 pika 1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt, në bazë të nenit 4 pika 1 nen 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 nenit 5, nenit 6 pika 1.1, nenit 7 pika 1, nenit 8 pika 1.1, nenit 14 pika 3 dhe 4, nenit 15 pika 1, neni 16 pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10/03 Prill 2019, Prishtinë, në përputhshmëri me (Vendim të Kuvendit të Komunës së Skenderajt Nr. 01-463/01-0076422/19, dt. 31/12/2019, Konfirmimi I ligjshmërisë së MAPL-së Nr. 020-7/1, i dt. 20.01.2020, mbështetur në vendimin Nr. 01-463/01-0076423/19 i dt.31.12.219, Konfirmimi I ligjshmërisë së MAPL-së Nr. 020-7/2, i dt. 20.01.2020 për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim afatshkurtër prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite vendosi:

1. Ofertuesi “ELKOS GROUP” oferta e dt. 27.02.2020, me nr.01-463/02-0010607/20, I ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara në KONKURSIN (ankandin) publik me numër. 01-463/02-0008083/20, i datës . 12.02.2020.
2. Aprovohet oferta e datës. 27.02.2020, me numer.01-463/02-0010607/20, dhe sipas procedurave Ofertuesi “ELKOS GROUP” është fitues i Ankandit Publike numër. 01-463/02-0008083/20, i datës. 12.02.2020.
3. Ky vendim behet i plotfuqishëm pasi të miratohet në Kuvendin Komunal të Skenderaj.

ARSYETIM

Komisioni ka hartuar dhe publikuar kushtet e pjesëmarrjes dhe kriteret në Konkursin (ankandin) publik me numër protokoll nr. 01-463/02-0008083/20, i dt. 12.02.2020.

LENDË E KONKURSIT (ankandit) PUBLIK.

Lëndë e ankandit publik është toka e pandërtuar ndërtimore, pronë e Komunës së Skenderajt, ngastra numër 550-3 dhe ngastra numër 549 – 0 me sipërfaqe të tërësishme 7794 metra katror, certifikata e pronësisë me numër 73991/19 i datës 16 / 12 / 2019 , e paraparë me Planin Zhvillimor Urban dhe Planin Rregullativ të qytetit të Skenderajt, miratuar nga Kuvendi i Komunës në Vendimin 01Nr. 350-73 të datës 07.10.2011, me dedikim për ndërtimin e objekteve me destinim afarizëm-banim, (sipas kriertereve ndërtuese të percaktuara nga DUMA), sqarimi urbanistik numer 05-350/02-0074083/19 i dates 17 / 12 / 2019.

TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË KONKURS (Ankand) Publik

Te drejtë për pjesëmarrje në ankand kanë:

- Personat juridik: person juridik i vendit, person juridik në pronësi të pëzier dhe personi juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar në regjistrin përkatës të Republikës së Kosovës, persona juridik të huaj rezidentë të vendeve anëtare të Unionit Evropian dhe të OECD-së.

Në prezenc të Komisionit ofertuesi zotohet së në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt do të sponsorizoj njërin nga klubet sportive të komunës të Skenderajt, ndonjë nga aktivitetet kulturore sipas dispozitave të ligjit nr. 05/L -090 Për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ndërtimi i Objektit në madhësi prej tremijë e njëqind e dyzet e katër metra e pesëdhjet e dy centimetra (3.144.52) metra katrorë Qendër Tregtarë dhe pikë Grumbulluese (Qendër Agrare për fruta dhe perime), ndërtimi behet në Zonën Kadastrale Skenderaj në pronësi të Kuvendit Komunal, numri I njësisë së Kadastrave 550-3 dhe 549-0 Certifikata numer.73991/19 i datës.16.12.2019, me sipërfaqe 7794m2.

Komisioni me datë 27.02.2020 në ora 15 : 30 me procesverbal ka hapur ofertën e konkursit (ankandit) publik oferta e dt. 27.02.2020, me numer .01-463/02-0010607/20, në sallën e mbledhjes së drejtorëve në objektin e komunës siç është parapara në konkursin (ankandin) publike me numer. 01-463/02-0008083/20, i dt. 12.02.2020, në ora 15:30, në prezencë të përfaqësuesve të Ofertuesit “ELKOS GROUP” me numër të biznesit 810413584, i përfaqësuar nga Kastriot Kelmendi i lindur me 20.06.1984 në Pejë, me numër Personal 2015286337, dhe në përbërje të komisionit: 1. Ramiz Shala-Kryesues; 2. Kastriot Gashi-anëtar; 3. Pajazit Isufi-anëtar; 4. Fatlume Kodra-anëtare; 5. Gentiana Zeqiri- anëtare.

1. Ofertuesi “ELKOS GROUP” ka realizuar të drejtën për pjesëmarrje në Konkurs (Ankand) Publik sipas kriterëve të parapara për persona Juridik.
2. Ofertuesi “ELKOS GROUP” i ka plotësuar të gjitha kushtet për pjesëmarrje në Konkursin (Ankandin) publik dhe shpallet fitues i Konkursit (Ankandit) Publik.
3. Vlera investive nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë euro e dymbdhjetë euro - cent (975.932.12).
4. Madhësia e objektit tre mijë e njëqind e dyzet e katër metra e pesëdhjetë e dy centimetra katror (3. 144. 52).
5. Vende të lira pune 75 punëtores +/- 20%.
6. Paga mesatare katërqind e shtatëdhjetë e nëntë (479.00) euro.
7. Plani dinamik i realizimit të projektit nëntëdhjetë (90) ditë pune.

Këshille Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e marrjes së vendimit.

Komisioni vlerësues i ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës.

1. Ramiz Shala-kryesues
2. Kastriot Gashi-anëtar
3. Pajazit Isufi-anëtar
4. Fatlume Kodra-anëtare
5. Gentiana Zeqiri-anëtare

I dërgohet:

1. Arkivit.
2. Sekretarisë së Kuvendit Komunal .
3. Palës (ofertuesit “ELKOS GROUP”).

Skenderaj me 09 mars 2020

Lume's Details

Estetik & Depilim

Fatlume Shabani

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Salloni i Depilimit ‘Lume’s Details’
në Prishtinë kërkon një
praktikante e cila pastaj mund të
punësohet me pagesë nëse tregon
rezultat të mirë gjatë kohës së
praktikës.**

**Të interesuarat mund të paraqiten
në këta numra kontaktues:
045681898 dhe 044900978**



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVO/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO
ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Bazuar në vendimin e KZKA, Nr. 03/2020 të datës 04.03.2020, me Nr. Protokoli 964/2020, të datës 04.03.2020, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë 04.09.2019, Nr. Ref. 55/2019, për pozitën Zyrtar për Arkiv.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu odluka KRPŽ Br. 03/2020, datuma 04.03.2020, sa Br.Protokola 964/2020, datuma 04.03.2020, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, obaveštava o anuliranju, obavljenog konkursa, datuma 04.09.2019, Br. Ref. 55/2019, za poziciju Zvaničnik za Arhivu.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVO/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO
ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Bazuar në Vendimin e KZKA, Nr. 02/2020, të datës 04.03.2020, me Nr. Protokoli 963/2020, të datës 04.03.2020, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë 04.09.2019, Nr. Ref. 57/2019, për pozitën Zyrtar i Lartë i Promovimit.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu odluka KRPŽ, Br. 02/2020, datuma 04.03.2020, sa Br.Protokola 963/2020, datuma 04.03.2020, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, obaveštava o anuliranju, obavljenog konkursa, datuma 04.09.2019, Br. Ref.57/2019, za poziciju Viši Zvaničnik za Promociju.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 ☎ +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.SH. "Auto Color Dritoni" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70620383.

► Përparim Burinxhiku shpall të pavlefshme diplomën SHMT "Anton Çetta" dhe dëftesat e vitit (X-XIII) Skenderaj.

► Zenel Gjinovci. Shpall të pavlefshme dëftesat e SHF (kl I-VIII) "Elena Xhika" Makermal.

► Haxhi Hasani shpall të pavlefshme diplomën e SHMGJ "Hamez Jashari" Skenderaj.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Shaban Musliu, shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të -I- të shkollës së mesme teknike "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë.

► Albana Pacaj shpall të humbur diplomën e Fakultetit të Mjekësisë- Departamenti Infermieri në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

► Rustem Shaban Kosumi, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Elena Gjika" në Prishtinë.

► Shpallet e pavlefshme certifikata e biznesit "Ndërmarrja e Re, Lavertaria-Blektoria "Toka Bujqësore"- Lubizhdë Sh.p.k, me numër të regjistrimit të biznesit: 70801388.

► Dafina Shabani nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" në Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173
045 626 123
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020

